

RAPORTI VJETOR 2025

SIGAL 2.0

New Rhythm

Volumi i primeve (Euro)

Grupi	142,700,000
AL	78,890,000
KS	27,585,000
MKV	36,225,000

Nr. i zyrove

Grupi	1443
AL	662
KS	268
MKV	513

Nr. i kontratave

Grupi	1,927,617
AL	567,978
KS	242,799
MKV	1,116,840

Agjentë dhe punonjës

Grupi	2062
AL	936
KS	440
MKV	686



PËRMBAJTJA

4 Mesazhi i CEO-s

6 Kush është SIGAL

10 Ngjarjet kryesore

16 Jehona Mediatike

25 RISI & PRODUKTE

27 Përgjegjësi Sociale

33 Vlerësime

40 Tregu i Sigurimeve

46 Të dhëna financiare

48 Raporti i Pavarur i Audituesve

98 Raporti Auditit të Brendshëm

131 Raport i vetëvlerësimit të reziqeve





**NE NUK PAGUAJMË VETËM DËME.
NE RIKTHEJMË STABILITETIN.
NE RIKTHEJMË DINJITETIN.
KY ËSHTË THELBI I SIGURIMEVE.**

Të dashur partnerë, klientë dhe bashkëpunëtorë,

Viti 2025 shënon 26 vite histori suksesi për SIGAL Insurance Group. Një rrugëtim që nisi me një vizion të qartë: të ndërtonim një kompani sigurimesh që nuk shet thjesht polica, por ndërton besim.

Sot, SIGAL është lider i padiskutueshëm në tregun shqiptar dhe aktor i rëndësishëm rajonal në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ne paguajmë mbi 26% të tregut të sigurimeve të jetës dhe Jo-jetës ku operojnë 12 kompani. Këto nuk janë vetëm statistika – janë prova e përgjegjësisë sonë. Në një kohë pasigurish globale, ndryshimesh klimatike dhe sfidash ekonomike, sigurimet janë instrument i dinjitetit njerëzor. Ato ndërtojnë liri ekonomike dhe pavarësi familjare.

Vizioni ynë për 2026 është i qartë:

- Zhvillim i produkteve vullnetare
- Rritje e penetrimit të sigurimeve
- Digjitalizim i avancuar
- Edukim financiar i brezave të rinj

Ne nuk jemi thjesht një kompani sigurimesh. Ne jemi arkitektë të sigurisë ekonomike në rajon.

Avni Ponari

CEO, SIGAL Insurance Group

SIGAL, 26 VITE HISTORI SUKSESI!

Prej vitit 1999, SIGAL ka qenë sinonim i sigurisë, besueshmërisë dhe inovacionit në tregun e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Sot, kompania më e madhe e sigurimeve në vend shënon një moment të rëndësishëm – 26 vite suksesi, rritjeje dhe përkushtimi ndaj klientëve dhe partnerëve të saj. Nga hapat e parë e deri më sot, SIGAL ka arritur të ndërtojë një rrjet të fuqishëm sigurimesh, duke ofruar mbrojtje dhe stabilitet për miliona qytetarë e biznese. Me një histori të pasur sfidash dhe arritjesh, kjo kompani ka qenë gjithmonë një hap përpara në përshtatjen me kohën dhe nevojat e tregut.

Në një mesazh të veçantë për të gjithë klientët dhe bashkëpunëtorët besnik të SIGAL, themeluesi dhe CEO i SIGAL, z. Avni Ponari, ndan rrugëtimin e kompanisë dhe vizionin për të ardhmen. “Përvjetoret janë momente të rëndësishme, pasi mbartin brenda vetes madhështinë e një historie suksesi. Kanë kaluar 26 vite nga dita kur SIGAL nisi këtë rrugëtim, duke u bërë sot një nga

brandet më të njohura dhe të besuara jo vetëm në Shqipëri, por edhe në tregjet ndërkombëtare. Këto vite kanë qenë një udhëtim me sfida, përpjekje dhe arritje të mëdha, me një staf të përkushtuar, produkte inovative dhe një strategji që ka udhëhequr tregun e sigurimeve në rajon. Sot, SIGAL është më shumë se një kompani – është një urë e fortë bashkëpunimi me partnerët më të fuqishëm europianë dhe një shkollë për breza të tërë profesionistësh”, theksoi Ponari. CEO i SIGAL, z. Ponari, shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë rrugëtim të jashtëzakonshëm: “Sot unë ndihem krenar që SIGAL është një brand mjaft i njohur jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Mjaft i njohur në tregjet botërore dhe një nga kompanitë më të besuara. Partnerët tanë sot në Europë janë më të fuqishmit dhe së bashku me ta ne ndërtojmë një urë të rëndësishme, një kompani që ka vlera të jashtëzakonshme kombëtare dhe ndërkombëtare, e që është bërë një shkollë e madhe për të gjithë stafin e SIGAL, për të gjithë stafet e kompanive të tjera dhe për gjithçka të ndërtuar në industrinë e

sigurimeve. Unë shpresoj që shumë shpejt do të marrë vlera edhe më të mëdha”, tha z. Ponari

Ai uroi të gjithë stafin e kompanisë lider në tregun e sigurimeve në tre shtetet, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, si dhe bashkëpunëtorët ndër vite e klientët për besimin. “Urime stafit të SIGAL! Urime të gjithë atyre që na kanë shoqëruar këto vite që janë më të rëndësishmet për ne, të gjithë klientët tanë në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut! Sepse së bashku ne vazhdojmë të krijojmë atë që kemi nisur 26 vite më parë. Gëzuar të gjithëve!”

Me mbi 300 zyra dhe një rrjet prej mbi 2000 punonjësish, SIGAL vazhdon të jetë lider në sektorin e sigurimeve, duke sjellë vazhdimisht inovacione dhe shërbime të përshtatura për nevojat e klientëve.

Për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi – punonjësit, partnerët dhe klientët – kjo ditë është një moment për të festuar suksesin dhe për të parë drejt të ardhmes me ambicie edhe më të mëdha.

Kush është SIGAL?

SIGAL është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Kompania kryeson tregun e sigurimeve prej vitit 2002, duke zënë rreth 30% të tij në Sigurimet e Jetës, Jo-Jetës dhe Pensionit Privat.

E themeluar në Shkurt 1999, SIGAL operon suksesshëm në të trija shtetet përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurime Jo-Jetë, 3 Sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Portofoli i SIGAL Group është i risiguruar në tregjet më të mëdha botërore teksa kompania bashkëpunon me emra të mëdhenj si: Allianz, AXA, Zurich Re, 'UNIQA Re', 'Munich Re', 'Hannover' Re, AIG dhe IF duke ofruar një garanci më shumë për mbi 1.5 milion klientët e saj.

Ritmet e progresit të SIGAL kanë bërë që shumë publikime profesionale në fushën e sigurimeve ta vlerësojnë atë me shumë çmime dhe vlerësime.



NR.1

në tregun e sigurimeve



1.2 milionë

klientë AL, KS, MKV



3 shtete

AL, KS, MKV

Misioni ynë

Një kompani shqiptare me standarde evropiane si SIGAL e ka të qartë misionin e saj: të paguajë në kohë rekord dëmet dhe të mbrojë qytetarët mbi bazën e kontratave të sigurimit.

Përgjatë 25 viteve punë, SIGAL si Grup ka paguar më shumë se 500 milionë euro dëme, shifër kjo që tregon qartë seriozitetin, qëndrueshmërinë financiare dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve të saj. Vetëm për dy tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL ka paguar afro 20 milionë euro dëme për klientët e saj.

Krahas përgjegjshmërisë kontraktuale, SIGAL ka dëshmuar përkujdesje maksimale për komunitetin, duke kontribuar në shëndet, art, kulturë, trashëgimi kulturore, sport, turizëm dhe arsim me miliona euro ndër vite.

Vepra të tilla si rikonstruksioni i Teatrit Skampa në Elbasan pas djegies totale, rikonstruksioni i Kinema Millenium Korçë, rikonstruksioni i shtëpisë muze në Korçë e Berat, rikonstruksion shkollash dhe pajisje me mjete shkollore, të gjitha këto mbajnë emrin SIGAL.

Sepse e tillë duhet të jetë një kompani, e cila jo vetëm të marrë por edhe duhet t'i japë mbrapsht komunitetit, nëpërmjet investimeve në fusha të ndryshme. Kjo ka qenë motoja jonë si SIGAL që prej fillimit dhe do të vazhdojë të jetë edhe për të ardhmen.

Sepse ne besojmë që zhvillimi jonë shkon krah për krah me zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë.

SIGAL 2.0 Plani ynë strategjik

Përmbledhje e programit strategjik të SIGAL



Këshilli Mbikëqyrës SIGAL Insurance Group



NAIM HASA

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës,
SIGAL Insurance Group



BESNIK MUSTAJ

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës,
SIGAL Insurance Group



TURGAY DEMIREL

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës,
SIGAL Insurance Group

Bordi Drejtrues i Grupit SIGAL




AVNI PONARI
CEO, Grupit SIGAL në Shqipëri,
Kosovë, Maqedoni e Veriut



EDVIN HOXHA
Drejtör i Përgjithshëm
SIGAL Life Shqipëri



ELVIS PONARI
Administrator i Përgjithshëm
Fondi i Pensioneve SIGAL



ALMA TOTOKOÇI
Zv. Drejtör i Përgjithshëm
SIGAL Shqipëri



ILIR HALILAJI
Zv. Drejtör i Përgjithshëm
SIGAL Shqipëri



PËRPARIM DRINI
Drejtör Ekzekutiv
SIGAL Jo-Jetë Kosovë



KALTRINA GASHI
UD. Drejtore Ekzekutive
SIGAL Life Kosovë




DRITON AZIZI
CEO
SIGAL Jo-Jetë Maqedoni e Veriut



ALEKSANDRA ANTOVSKA
CEO
SIGAL Life Maqedoni e Veriut

Struktura e Grupit SIGAL



90%

SIGAL Business Center



10%

Avni Ponari



Ngjarjet Kryesore

TAKIMI RAJONAL I GRUPIT SIGAL: **STRATEGJI DHE OBJEKTIVA PËR NJË TË ARDHME TË SIGURT**



Bordi Drejtorues e SIGAL Insurance Group
në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut

Valbonë, 24 Shkurt 2025 – Grupi SIGAL ka zhvilluar Takimin Rajonal në ambientet e Valbona Resort, ku drejtuesit dhe përfaqësuesit e kompanisë janë mbledhur për të diskutuar strategjitë dhe objektivat kryesore për vitin e ardhshëm. Ky takim përfaqëson një moment kyç në rrugëtimin e kompanisë drejt inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve të sigurimit në tregun shqiptar dhe më gjerë.

Në këtë mbledhje të nivelit të lartë, u analizuan performanca aktuale dhe sfidat me të cilat është përballur kompania, duke vendosur një fokus të veçantë në rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e eksperiencës së klientëve dhe zhvillimin e produkteve të reja të sigurimit. Diskutimet u përqendruan gjithashtu në strategjitë për fuqizimin e pranisë së SIGAL në treg dhe në angazhimin për të ofruar zgjidhje inovative që adresojnë nevojat gjithnjë në ndryshim të klientëve.

Drejtues të lartë të Grupit SIGAL theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis ekipeve rajonale për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe për të adresuar sfidat me një qasje të integruar dhe efektive. Gjithashtu, u prezantuan nisma të reja në fushën e dixhitalizimit dhe teknologjisë, të cilat synojnë të ofrojnë një shërbim më të shpejtë, të sigurt dhe të lehtë për klientët.

Takimi Rajonal i Grupit SIGAL shërben si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave mes ekipeve në nivel kombëtar dhe rajonal, duke forcuar më tej filozofinë e kompanisë për të qenë gjithmonë një hap përpara në industrinë e sigurimeve.

Me një angazhim të palëkundur për sukses dhe përmirësim të vazhdueshëm, SIGAL mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt për klientët e saj dhe për të ruajtur pozicionin e saj lider në tregun e sigurimeve.





SIGAL INSURANCE GROUP NË MONTE KARLO PËR TAKIMET VJETORE TË RISIGURUESVE

SIGAL Insurance Group, i përfaqësuar nga CEO, z. Avni Ponari dhe një sërë drejtues të lartë të grupit, mori pjesë në takimin vjetor me risiguruesit dhe brokerat në Monte Karlo, një ngjarje kyçe në kalendarin e risigurimeve me mbi 60 vjet histori.

Ky event, i njohur si Rendez-Vous de Septembre (RVS), mbledh risiguruesit, brokerat dhe klientët e tyre në Principatën e Monakos.

Pjesëmarrja e SIGAL në këtë forum është një mundësi e rëndësishme për të forcuar

partneritetet ekzistuese dhe për të krijuar bashkëpunime të reja me liderët më të mirë të industrisë së sigurimeve.

Drejtuesit, ekzekutivët, nënshkruesit, brokerat, blerësit, ofruesit e kapitalit të riskut dhe ofruesit e shërbimeve të industrisë diskutuan strategjitë e tyre dhe pozicionimin për sezonin e ardhshëm të rinovimeve.

Qëllimi i SIGAL është i qartë: të sjellë ekspertizën dhe mbështetjen globale në shërbim të mbrojtjes së klientëve, duke garantuar siguri dhe besueshmëri në çdo hap.

KOSOVA FINANCE FORUM 2025

CEO i SIGAL: Mungesa e kulturës dhe ndërgjegjes siguruese duhet luftuar me edukimin për sigurimet



Kosova Finance Forum 2025 është një platformë e rëndësishme rajonale që synon të bashkojë aktorët kryesorë të ekonomisë, financave, sigurimeve dhe inovacionit për të diskutuar sfidat dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe në rajon.

Qëllimi kryesor i forumit është:

- të nxisë dialogun ndërmjet sektorit privat, institucioneve publike dhe ekspertëve financiarë;
- të promovojë edukimin financiar dhe ndërgjegjësimin për rolin e industrive financiare;
- të identifikojë politika dhe reforma që forcojnë stabilitetin financiar dhe rrisin investimet;
- të inkurajojë inovacionin dhe bashkëpunimin rajonal në fushën financiare.

Forumi shërben gjithashtu si një hapësirë për shkëmbimin e përvojave më të mira ndërkombëtare dhe për ndërtimin e strategjive afatgjata që mbështesin rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe integrimin më të shpejtë të rajonit në standardet evropiane.

Në forumin “Kosova Finance Forum 2025”, CEO i SIGAL, z. Avni Ponari, ishte i ftuar si folësi kryesor.

Z. Avni Ponari thekson rëndësinë strategjike të industrisë së sigurimeve për zhvillimin financiar dhe ekonomik të vendeve të rajonit. Ai e konsideron këtë industri si një nga tre shtyllat kryesore të sistemit financiar, krahas bankave dhe pensioneve, duke nënvizuar se roli i saj shkon përtej biznesit dhe shërben si instrument emancipues për qytetarin.

Duke u mbështetur në përvojën e tij rreth 30-vjeçare, ai evidenton se Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë nivel shumë të ulët të primeve për frymë krahasuar me vendet e BE-së. Sipas tij, kjo diferencë nuk shpjegohet vetëm me faktorë ekonomikë, por edhe me mungesën e kulturës siguruese, edukimit financiar dhe kuadrit ligjor të përshtatshëm.

Ponari argumenton se qytetarët nuk duhet të mbështeten vetëm te shteti, por duhet të ndërtojnë sigurinë e tyre financiare përmes sigurimeve vullnetare. Ai sjell shembuj nga vende të zhvilluara për të treguar se një shoqëri me ndërgjegje të lartë siguruese është më e pavarur dhe më dinjitoze.

Ndër rekomandimet kryesore, ai përmend:

- rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin për sigurimet në të gjitha nivelet e shoqërisë;
- përmirësimin dhe modernizimin e legjislacionit që mbron interesat financiare të qytetarëve;
- bashkëpunimin afatgjatë midis industrisë, ligjvënësve dhe institucioneve financiare.

Në përfundim, ai thekson se zhvillimi i fortë i industrisë së sigurimeve është kusht i domosdoshëm për integrimin e plotë të rajonit në Bashkimin Evropian dhe për ndërtimin e një qytetarie ekonomike të pavarur.

BIZNESET SHQIPTARE NË KOSOVË BASHKQHEN PER ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM EKONOMIK



Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, me mbështetjen e SIGAL IG, organizoi një aktivitet të rëndësishëm ekonomik, me qëllim forcimin e lidhjeve mes bizneseve shqiptare që operojnë në Kosovë.

Ky takim shërbeu si një platformë bashkëpunimi për sipërmarrësit shqiptarë nga të dy vendet, duke synuar rritjen e partneriteteve ekonomike, shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e mundësive të reja investimi.

Në aktivitet, si mbështetës dhe sponsorizues, mori pjesë edhe CEO i SIGAL Insurance Group, z. Avni Ponari.

SIGAL IG, kompani e cila operon në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut mbështet nismat kombëtare që kontribuojnë në

zhvillimin ekonomik si dhe në integrimin rajonal.

Në këtë veprimtari mbajtën fjalë rasti edhe z. Petrit Malaj, ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, dhe z. Avni Ponari, CEO i SIGAL Insurance Group.

Gjatë fjalës së tyre, të dy theksuan rëndësinë e bashkëpunimit, partneritetit dhe vizionit të përbashkët për ndërtimin e një të ardhmeje më të fortë dhe më të qëndrueshme ekonomikisht për hapësirën shqiptare.

SIGAL vetëm pak ditë më parë shënoi 22 vjet operim me sukses, duke konfirmuar veten në pozita shumë të shëndosha edhe në tregun e Kosovës, si pjesë e denjë e familjes SIGAL IG, që është kompania më e besuar e sigurimeve në rajon.



Jehona Mediatike

PONARI PËR USA TODAY: NE PËRPIQEMI TË JEMI MË SHUMË SE NJË OFRUES SIGURIMESH DUKE NDËRTUAR BESIM

SIGAL Group është një nga kompanitë kryesore të sigurimeve në Shqipëri, me operacione në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Me mbi 2,000 punonjës, kompania ka qenë prej kohësh një pioniere në sektorin e sigurimeve në Shqipëri, duke zgjeruar tregun përmes ofertave të reja të produkteve dhe një fokusi te nevojat e klientëve.

“Suksesi ynë qëndron në kreativitetin dhe përkushtimin e ekipit tonë, të cilët inovojnë vazhdimisht për të ofruar produkte dhe shërbime të reja për klientët,” pohon CEO Avni Ponari.

Gjatë gjithë evolucionit të kompanisë, inovacioni ka qenë një shtytës kryesor—si në zgjerimin e vazhdueshëm të portofolit të produkteve ashtu edhe në përqafimin e shpejtë të dixhitalizimit. Shitjet online u lançuan më shumë se një dekadë më parë, ndërsa klientët mund të aksesojnë shërbime dixhitale, si raportimi i dëmeve shëndetësore dhe ofrimi i telemjekësisë 24/7 përmes aplikacionit të SIGAL.

“Historia jonë është një histori qëndrueshmërie, rritjeje dhe inovacioni,” thotë Ponari. “Ne përpiqemi të jemi më shumë se një kompani sigurimesh duke ndërtuar besim, duke ofruar zgjidhje të reja dhe duke i dhënë diçka mbrapsht komuniteteve që shërbejmë.” Ky përkushtim ndaj shërbimit të komunitetit është më shumë se një slogan. Programi i



gjerë i përgjegjësisë sociale të kompanisë përfshin operimin e një klinike shëndetësore mobile të drejtuar nga mjekë për të ofruar shërbime shëndetësore falas në zonat e largëta, sponsorizimin e ekipeve të ndryshme sportive, përfshirë Kombëtaren Shqiptare të Futbollit, dhe orkestrën SIGAL, e cila performon në të gjitha vendet e operimit të kompanisë.

Vendosmëria për të nxitur zhvillimin e Shqipërisë shtrihet edhe në një nivel më të gjerë. SIGAL është një lider në sigurimin e projekteve kyçe të infrastrukturës në Shqipëri, duke bashkëpunuar me ofruesit kryesorë evropianë të risigurimeve. Ky kombinim strategjik i ka siguruar kompanisë një pjesë tregu prej 30%, duke regjistruar një rritje prej 10% deri në 20% në vit.

Për Ponarin, megjithatë, Shqipëria ofron mundësi të shumta, që do të thotë se ky është vetëm fillimi: “Qëllimi im është që të ardhurat tona të trefishohen gjatë pesë viteve të ardhshme.”

OPINION nga AVNI PONARI, CEO i SIGAL.

BANKAT DHE SIGURIMET MBROJNË DEPOZITAT PËRMES SIGURIMIT TË JETËS DHE HIPOTEKËS



Viti 2024 shënoi rekordin historik të temperaturës globale. Shkrija e akullnajave, vdekjet nga nxehtësia dhe përhapja e sëmundjeve tropikale në Europën Qendrore e Veriore janë një alarm shëndetësor global.

Përmbytjet në Spanjë dhe zjarret në Greqi kanë goditur rëndë komunitetet. Në BE, përmbytjet shkaktojnë 12 miliardë euro dëme në vit. Ndërkohë, ndotja e ajrit vret mbi 500 mijë njerëz në Europë çdo vit. Këto fakte përbëjnë një alarm të dytë për sigurinë e pronave.

Një nga masat më të rëndësishme që ndërmarrin vendet e zhvilluara për të përballuar dëmet klimatike dhe shëndetësore janë sigurimet. Mesatarisht, qytetarët e 27 vendeve të BE-së paguajnë 2182 euro për frymë në vit për sigurime.

CEO i SIGAL, kompania më e madhe e sigurimeve në vend, z. Avni Ponari, në lidhje me rëndësinë e industrisë bën me dije si vijon:

Sigurimet janë një industri shumë e rëndësishme, ose quhet si kollona e tretë e ndërtimit të ekonomisë së një vendi, për vetë misionin që ka, por nga ana tjetër kjo industri ka edhe krijon personalitetin e njeriut. Njeriu që ka përmbushur me dinjitet dhe ka sigurimet e domosdoshme të shtëpisë, shëndetin, ka një pension privat, ka sigurimin e makinës, të apartamentit dhe sigurime të tjera individuale, ai është një njeri i qetë dhe i pavarur.

I pavarur sepse nuk do shkojë për asgjë te bashkia, te ministria apo spitalet. Këto i zgjidh privatisht në mënyrë të menjëhershme dhe krijon individualitetin e tij. Këtë ka kohë që e bën Evropa, sepse ata paguajnë 3 mijë euro për frymë në vit, ndërsa ne paguajmë vetëm 50 euro për frymë në vit. Pra, jemi aq larg nga ajo që duhet të shkojmë, sa e tregon edhe kjo shifër kaq e rëndësishme, sepse ne nuk kemi sigurime.

Ne kemi vetëm një sigurim të detyrueshëm, ndërsa të tjerat janë fakultative dhe pak veta që e kërkojnë. Ne duhet të luftojmë që me pak kursime, sepse çmimet e sigurimeve janë shumë të lira dhe të ulëta. Mbrojtja është e jashtëzakonshme. Shqipëria nuk e ka reflektuar ende pasigurinë e kohës që po jeton. Sot, Shqipëria paguan vetëm 65 euro për frymë, duke u renditur e fundit në Evropë, pas Kosovës (67 euro) dhe Maqedonisë së Veriut (100 euro).

Ndërkohë, vendi ynë po përballlet me temperatura ekstreme dhe rrezik të lartë sizmik. Vetëm në vitin 2025 janë regjistruar 186 lëkundje, më shumë se të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor së bashku.

Megjithatë, niveli i sigurimit për shëndetin dhe pronën mbetet i ulët, për shkak të mungesës së edukimit financiar dhe legjislacionit. Sigurimet janë mjeti më i sigurt për të mbrojtur jetën dhe pronën ndaj duhet kthyer në kulturë qytetare. Në këtë sfidë, partneri më i besuar mbetet SIGAL, prej 26 vitesh lider në treg.

FERMERI SHQIPTAR NËN PRESIONIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ponari: Sigurimi bujqësor zgjidhja e duhur

Sipas studimeve zyrtare, Shqipëria radhitet ndër vendet me risk të lartë për pasoja nga ndryshimet klimatike. Sektori që preket në mënyrë direkte nga këto ndryshime është bujqësia.

Breshëri, zjarret dhe sëmundjet e ndryshme të kulturave bujqësore kanë shkaktuar shpesh kosto të mëdha për fermerët shqiptarë.

Zjarret kanë shkrumbuar jo pak hektarë me ullinj në zonat bregdetare; sëmundjet dhe ngricat kanë dëmtuar frutikulturën në Juglindje; ndërsa vreshtat në Veri kanë qenë shpesh pre e rreziqeve të motit.

Fermerët shqiptarë i kanë mbuluar vetë kostot e larta të këtyre të papriturave, përkundër thirrjeve të pasuksesshme për zhdëmtim e ndihmë shtetërore.

Sigurimet bujqësore, sipas traditës perëndimore, ofrojnë mbrojtje financiare të shumëfishtë për fermerët.

CEO i SIGAL, z. Avni Ponari, për Top News sqaron se: “Shoqëritë e sigurimeve e kryejnë këtë mision që është një nga misionet më të rëndësishme dhe që i japin mundësinë çdo fermeri të ketë të mbuluar rreziqet dhe të jetë i kompensuar financiarisht për dëme të cilat mund të ndodhin dhe kjo fillon që nga lulëzimi i produkteve deri te prodhimi i tij.”

Në Shqipëri, SIGAL është kompania kryesore dhe e vetme që mbulon të gjithë ciklin bujqësor – nga lulëzimi i hershëm i farërave deri te prodhimi – duke garantuar kompensimin për humbjet e shkaktuara nga kushtet klimatike, për sa kohë fermeri ka marrë masat e nevojshme të dakordësuara në kontratë sigurimi gjatë kultivimit.



SIGAL ofron mbrojtje për të gjitha kulturat, përfshirë grurin dhe misrin.

Ponari: “SIGAL ka vite që mbulon me shumë sukses dhe ka me dhjetra klientë të cilët ofrohen dhe kanë marrë sigurimin e duhur duke u krijuar mundësinë atyre që të kompensohen financiarisht ... Çdo gjë që krijojmë me duart tona në fushën e bujqësisë është e mbuluar, dhe në çdo zyrë kudo në territorin e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë së Veriut SIGAL është prezent – mund të afroheni aty dhe të merrni shërbimin e duhur. Vlera e sigurimit nuk është e lartë; ajo përbën vetëm 3–6% të investimit të fermerit, një shpenzim i papërfillshëm krahasuar me atë që do të përfitohet në fund të sezonit.”

SIGAL ka vite që mbulon me sukses dhjetëra fermerë në të gjithë Shqipërinë dhe shembujt e suksesit janë të shumtë. Siguria financiare e fermerëve mbron të ardhurat e tyre dhe njëherësh siguron stabilitetin e furnizimit me ushqime, si edhe rrit besimin për investime të tjera. Në nivel makro, një bujqësi e mbrojtur mirë ul varfërinë rurale, krijon vende pune, rrit prodhimin dhe forcon ekonominë e vendit.

NGA RREZIKU NË MUNDËSI: ROLI I SIGURIMIT NË HOTELERI

Sezoni turistik po afron. Shifrat e viteve të fundit rrisin pritshmërinë për një verë dinamike, si në bregdet ashtu edhe në qytetet tona. Pritet rritja e numrit të turistëve, si të rinj ashtu edhe të rikthyer. Hotelet, resortet dhe strukturat akomoduese po përgatiten për të përballuar këtë fluks vizitorësh. Në mesin e këtyre përgatitjeve, si një nga sipërmarrësit e parë dhe pionier në tregun e sigurimeve, ndiej detyrimin t'ua kujtoj dashamirësisht sipërmarrësve në hoteleri dhe turizëm një çështje shpesh të anashkaluar: sigurinë. Në turizëm, ashtu si në çdo industri tjetër, sukseksi dhe siguria ecin bashkë. Kush synon suksesin, duhet të kujdeset për sigurinë.

Trendi i zhvillimit të turizmit në vend

Sukseksi është i mundshëm: le t'u hedhim një sy shifrave. Po t'i referohem të dhënave të fundit të INSTAT, akomodimi dhe shërbimi ushqimor në vitin 2023 shënonte

17,850 subjekte,
15.2% të sipërmarrjeve në vend,
57,000 të punësuar,
0.2% e totalit dhe një trend rritës nga viti në vit.

Nga shifrat vërehet një trend rritës i investimeve në shërbime, përfshirë këtu edhe hotelerinë dhe strukturat e ngjashme me to.

Trendi duket i pandalshëm, po të referohem te shifrat e muajit mars 2025, ku menjëherë fluksi i turistëve erdhi rritës, si në krahasim me muajt paraardhës, ashtu edhe me ata të një viti më parë për të njëjtën periudhë.

Sipas këtyre të dhënave, në muajin mars 2025, strukturat akomoduese shënuan një rritje të ndjeshme të vizitorëve të shprehur si numër vizitorësh por edhe si vëllim netësh qëndrimi.

21,9 % u rrit numri i vizitorëve

30.8% u rrit numri i netëve të qëndrimit

27.6% u rrit numri i vizitorëve jorezidentë në zonat bregdetare

20.6% u rrit numri i vizitorëve në zonat jo-bregdetare.

Shifrat japin një sinjal pozitiv për të ardhmen, por ftojnë edhe për reflektim: ato flasin për nevojën e një kapërcimi të madh, sipërmarrësit në hoteleri dhe shërbimet e ngjashme me to në sektorin e shërbimit duhet të përqafojnë sa më parë praktikatat perëndimore.

Ata duhet të investojnë në sigurinë e klientëve, stafëve dhe aseteve të tyre të biznesit, për t'i paraprirë çdo risku të mundshëm. Për më shumë sukses, duhet më shumë siguri.

Produktet e sigurimit për hotelerin

SIGAL, për këta investitorë, ofron të paktën tre produkte të mirëmenduara sipas nevojave të tregut ndërkombëtar:

1. Sigurimi i përgjegjësisë publike në hotele dhe restorante- që është edhe detyrim ligjor,
 2. sigurimi i pronës dhe aseteve të tjera të biznesit dhe
 3. sigurimi i punonjësve nga aksidentet.
- Certifikatat e sigurimit i bëjnë klientët të ndihen më të sigurt dhe më të qetë në zgjedhjen që bëjnë. Studimet tregojnë se siguria është fjala kyçe në procesin e zgjedhjeve dhe të planifikimit të pushimeve të familjet dhe invidët sot në botë. Për t'i përfutur tre produktet tona skema është e thjeshtë: përfitimet janë të qarta. Kostot janë fare minimale e lehtësisht të përballueshme për strukturat hoteliere apo të ngjashme me to.

Sigurimi i përgjegjësisë publike për hotele dhe restorante

SIGAL ka përshtatur një policë sigurimi të hartuar posaçërisht për pronarët, administratorët e hoteleve dhe restoranteve për sigurimin e të gjithë përgjegjësisë, që rrjedhin prej veprimtarisë së tyre.

Ky sigurim mbulon përgjegjësinë publike, që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë hoteliere, apo strukturave të ngjashme me to. Klienti që rrëshket nga shkallët e sapolara dhe dëmtohet, ornamentet në dekorin e hotelit që rrëzohet aksidentalisht dhe dëmton pushuesin, dëmtimi aksidental i turistit duke luajtur në pishinë, një gotë e thyer që dëmton klientin, helmimi nga pija apo ushqimi i klientit në barin apo restorantin e hotelit, cilado qofshin pasojat fundore, gjithçka mbulohet brenda kësaj pakete sigurimi. Secila prej këtyre ngjarjeve aksidentale mbart në vetvete riskun e komplikimeve jo vetëm ligjore, por edhe financiare nëse biznesi nuk e ka siguruar përgjegjësinë. Kjo barrë vjen si detyrim i hotelit ndaj klientit, i cili do ta detyrojë ligjërisht zhdëmtimin, por njëherësh mund të cënojë rëndë imazhin, reputacionin, besueshmërinë, markën e hotelit apo restorantit. Falë sigurimit të kësaj përgjegjësie, riskun për ju, deri në limitin e shumës së siguruar, e merr përsipër SIGAL.

Sa kushton?

Tarifat për këtë sigurim varen nga një numër faktorësh duke përfshirë kufirin e dëmshpërblimit që do të sigurohet.

Tarifa mesatare është **0,2% e limitit total të përgjegjësisë**, e thënë me fjalë të thjeshta: 0.2% e shumës që dëshiron të sigurosh, nëse është **1 milionë euro**, primi përlogarit vetëm **2 mijë euro**.

Sigurimi i pronës dhe i aseteve të tyre të biznesit

Produkti i dytë i sigurimit që do t'u sygjeroja sipërmarrësve në hoteleri dhe në strukturat e ngjashme me to është sigurimi i pronës dhe aseteve të tyre të biznesit. Asnjë strukturë turistike, për asnjë rast apo mundësi, nuk është immune, e paprekshme apo e paarritshme nga dëmet, që mund të shkaktojnë një fatkeqësi natyrore, zjarr aksidental, përmbytje. Me dhjetra raste në media, vetëm të vitit të fundit, tregojnë se investime të pasiguruara të strukturave hoteliere apo shërbimeve të ngjashme me to, u kthyen në pikën zero sa hap e mbyll sytë.

Sigurimi nga rreziqet do t'u kishte rikthyer, secilën prej tyre, në kohë rekord, brenda 30 ditëve punë, vlerën e plotë të dëmit të siguruar me vetëm **0.1% si çmim të primit**. 0.1% do të thotë se për një investim hotelierik **1 milionë euro, për vetëm 1 mijë euro në vit zhdëmtimi do të mund të ishte i plotë**.

Sigurimi i pronës garanton siguri financiare të operatorëve në turizëm dhe vazhdimësi të aktivitetit në raste dëmi apo humbjesh, duke i mbrojtur investimet dhe marrëdhëniet afatgjata me klientët.

Tërmet, zjarr, apo cilado fatkeqësi natyrore, nuk e le sipërmarrjen në pikën zero pas dëmtimit, sepse siguroesi, përmes zhdëmtimit, e ndihmon atë të rikthehet në kohë rekord në treg.

Sigurimi i stafit nga aksidentet Vetë punonjësi është themeli i suksesit të qëndrueshëm të një organizate. Në një fushë ku ritmi është intensiv dhe të papriturat janë pjesë e përditshmërisë, aksidentet në punë janë të mundshme dhe të shpeshta.

Sigurimi i punonjësit nga aksidentet në punë

jo vetëm që garanton mbrojtje financiare dhe rikuperim me dinjitet pas një dëmtimi, por rrit edhe

përkushtimin dhe cilësinë e shërbimit, duke e lidhur atë më fort me kompaninë. Punonjësi ndjehet i respektuar.

Për më tepër, ky sigurim shmang rreziqet e proceseve ligjore dhe dëmtimin e imazhit të biznesit. Në një treg që synon standarde europiane dhe konkurrueshmëri ndërkombëtare, mbrojtja e burimeve njerëzore nuk është më opsion, por domosdoshmëri.

Me prime minimale sigurimi dhe përfitime të konsiderueshme, sigurimi i punonjësve është një vendim i zgjuar dhe me ndikim afatgjatë për çdo strukturë turistike.

Sa janë këto prime?

Një punonjës që paguhet 10 mijë dollarë në vit, mund të sigurohet nga aksidentet në punë për vetëm 20 dollarë në vit, që do të thotë 0.2% e pagesë së tij dhe të përfitojë deri në 24 rroga mbulim pranë SIGAL në rast shpërbërjeje nga puna si pasojë e aksidentit.

Konkluzion

Në përfundim, rritja e vazhdueshme e turizmit në Shqipëri duhet të shoqërohet me një kulturë sigurie të mirëstrukturuar, ku mbrojtja e klientëve, stafit dhe aseteve të biznesit bëhet prioritet.

Investimi në sigurim nuk është vetëm një veprim parandalues. Ky investim përfaqëson një strategji inteligjente për të garantuar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e strukturave hoteliere në një treg gjithnjë e më konkurrues.

SIGAL ofron zgjidhje të standardit evropian për sigurimin e përgjegjësisë publike, pronës dhe punonjësve, me kosto minimale dhe përfitime maksimale. Në këtë mënyrë, sigurimi shndërrohet nga një rrezik i mundshëm në një mundësi konkrete për rritje, stabilitet dhe sukses afatgjatë në sektorin e turizmit.

SHQIPËRIA MES TËRMETEVE DHE ZJARREVE, POR PA KULTURË SIGURIMI. PONARI, CEO I SIGAL: SIGURIMET NDËRTOJNË LIRI DHE DINJITET



Viti 2024 shënoi rekordin historik të temperaturës globale. Shkrija e akullnajave, vdekjet nga nxehtësia dhe përhapja e sëmundjeve tropikale në Europën Qendrore e Veriore janë një alarm shëndetësor global.

Përmbytjet në Spanjë dhe zjarret në Greqi kanë goditur rëndë komunitetet. Në BE, përmbytjet shkaktojnë 12 miliardë euro dëme në vit. Ndërkohë, ndotja e ajrit vret mbi 500 mijë njerëz në Europë çdo vit. Këto fakte përbëjnë një alarm të dytë për sigurinë e pronave.

Një nga masat më të rëndësishme që ndërmarrin vendet e zhvilluara për të përballuar dëmet klimatike dhe shëndetësore janë sigurimet. Mesatarisht, qytetarët e 27 vendeve të BE-së paguajnë 2182 euro për frymë në vit për sigurime.

CEO i SIGAL, kompania më e madhe e sigurimeve në vend, z. Avni Ponari, në lidhje me rëndësinë e industrisë bën me dije si vijon:

Sigurimet janë një industri shumë e rëndësishme, ose quhet si kollona e tretë e ndërtimit të ekonomisë së një vendi, për vetë misionin që ka, por nga ana tjetër kjo industri ka edhe krijon personalitetin e njeriut. Njeriu që ka përmbushur me dinjitet dhe ka sigurimet e domosdoshme të shtëpisë, shëndetin, ka një pension privat, ka sigurimin e makinës, të apartamentit dhe sigurime të tjera individuale, ai është një njeri i qetë dhe i pavarur.

I pavarur sepse nuk do shkojë për asgjë te bashkia,

te ministria apo spitalet. Këto i zgjidh privatisht në mënyrë të menjëhershme dhe krijon individualitetin e tij. Këtë ka kohë që e bën Evropa, sepse ata paguajnë 3 mijë euro për frymë në vit, ndërsa ne paguajmë vetëm 50 euro për frymë në vit. Pra, jemi aq larg nga ajo që duhet të shkojmë, sa e tregon edhe kjo shifër kaq e rëndësishme, sepse ne nuk kemi sigurime.

Ne kemi vetëm një sigurim të detyrueshëm, ndërsa të tjerat janë fakultative dhe pak veta që e kërkojnë. Ne duhet të luftojmë që me pak kursime, sepse çmimet e sigurimeve janë shumë të lira dhe të ulëta. Mbrojtja është e jashtëzakonshme.

Shqipëria nuk e ka reflektuar ende pasigurinë e kohës që po jeton. Sot, Shqipëria paguan vetëm 65 euro për frymë, duke u renditur e fundit në Evropë, pas Kosovës (67 euro) dhe Maqedonisë së Veriut (100 euro).

Ndërkohë, vendi ynë po përballët me temperatura ekstreme dhe rrezik të lartë sizmik. Vetëm në vitin 2025 janë regjistruar 186 lëkundje, më shumë se të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor së bashku.

Megjithatë, niveli i sigurimit për shëndetin dhe pronën mbetet i ulët, për shkak të mungesës së edukimit financiar dhe legjislacionit. Sigurimet janë mjeti më i sigurt për të mbrojtur jetën dhe pronën ndaj duhet kthyer në kulturë qytetare. Në këtë sfidë, partneri më i besuar mbetet SIGAL, prej 26 vitesh lider në treg.

E ardhmja fillon sot: RINIA DHE PENSIONI PRIVAT

Në një botë që ndryshon çdo ditë, e ardhmja nuk është më diçka e largët – ajo është këtu, përballë nesh.

Dhe në këtë realitet të ri, një nga sfidat më të mëdha për çdo të ri nuk është thjesht të gjejë një punë të mirë, por të ndërtojë sigurinë financiare për nesër.

Shumë të rinj shpesh e shtyjnë mendimin për të ardhmen financiare, duke menduar se është ende herët për të planifikuar.

Pikërisht këtë qasje synon të ndryshojë SIGAL Invest – duke i nxitur të rinjtë të fillojnë sot, me hapa të vegjël, por me ndikim të madh në të ardhmen.

Në një intervistë për mediat, zëvendës drejtori i SIGAL Invest, Edmond Koçi, thekson se investimi nuk është vetëm për ata që kanë shumë të ardhura – por për këdo që ka një vizion për nesër. Të rinjtë shpesh e shohin pensionin si një çështje të largët – diçka për të cilën do të mendojnë “kur të vijë koha.”

“Të fillosh të investosh herët është një nga zgjedhjet më të mençura që mund të bësh për veten. Në SIGAL Invest, besojmë se çdo person – pavarësisht moshës – ka potencialin për të ndërtuar një të ardhme financiare të fortë. Për këtë arsye, kemi krijuar zgjidhje të thjeshta, transparente dhe të besueshme, posaçërisht për të rinjtë që duan të marrin kontrollin mbi financat e tyre dhe të investojnë me vetëdije.

Koha është një aleat i fuqishëm – dhe kur e vendos në funksion të zgjuarsisë financiare, përfitimet janë të mëdha dhe afatgjata.

SIGAL PENSION

Zbatije në sigurimet vullnetare Sigal

Merr paketën që të nevojitet

INVESTO 10.000

Pensioni mujor sipas viteve të kontributit.	10 VITE	20 VITE
	15 800 lekë	25 000 lekë

Deri në **4.55%** kthim

www.fondisigal.com.al

Me platformën tonë moderne dhe të sigurt, ju mund të kurseni, të investoni dhe të monitoroni në kohë reale rritjen e fondeve tuaja. Ne jemi këtu për t'ju qëndruar pranë në çdo hap të këtij udhëtimi. SIGAL Invest është partneri juaj i besueshëm në rrugën drejt një të ardhmeje të sigurt dhe të qëndrueshme financiarisht. Mos prit më – ndërmerr hapin sot. Investo në të ardhmen tënde dhe ndërto jetën që synon", tha ai. SIGAL Invest ofron një model të avancuar të kursimit për pension, me standarde evropiane. Çdo kontribues përfiton përfitime tatimore, rritje reale të kursimeve përmes investimeve të menaxhuara, dhe mundësi menaxhimi personal të investimeve sipas riskut dhe objektivave. Ky sistem është ideal për të rinjtë, duke ofruar fleksibilitet, praktikë dhe mundësinë për të ndërtuar autonomi financiare afatgjatë. Dhe kujtoni, është më mirë të keni një fond pensioni privat Sigal Uniq Invest sesa të prisni ditën që t'ju dalin flokët gri dhe të mendoni “po mos kisha kursyer edhe pak.

PONARI, CEO I SIGAL: INVESTIMET NË FONDIN E PENSIONEVE 100% TË GARANTUARA, TRANSPARENTE DHE TË TRASHËGUESHME



Në një intervistë të fundit për Premium Channel, CEO i SIGAL, Avni Ponari, theksoi rëndësinë e edukimit financiar dhe të investimeve afatgjata, sidomos në fondet private të pensioneve. “Kemi hyrë në ekonominë e tregut pa ditur mirë se çfarë është ajo”, u shpreh Ponari, duke kujtuar se sot ekonomia shqiptare është pothuajse e privatizuar dhe kërkon nga qytetarët njohuri të reja për të ndërtuar të ardhmen e tyre financiare.

Ai nënvizoi se niveli i investimeve në fondet private të pensioneve në Shqipëri mbetet shumë më i ulët

se mesatarja evropiane. Sipas tij, ndërsa në vendet e BE-së investimi arrin mbi 3000 euro për frymë, në Shqipëri varion mes 50 dhe 80 euro.

“Ky është një tregues që jemi ende shumë larg objektivit”, tha Ponari, duke shtuar se pensioni privat është një kujdes personal i domosdoshëm, ndonëse shpesh shihet si diçka e largët.

Ponari solli edhe një shembull konkret nga Italia: një mik i tij merrte një pension shtetëror prej 800–1000 eurosh, por falë investimeve të tij të hershme në tre fonde private, arrinte të siguronte 8000 euro në muaj për 15 vjet.

“Kjo tregon fuqinë e fondeve private të pensioneve”, theksoi ai. Në Shqipëri, skema është krejtësisht vullnetare, por përfitimet janë të dukshme. Një individ mund të investojë qoftë edhe 400 mijë lekë në muaj (të vjetra), shumë që nuk tatohet, duke përfituar kështu një fitim minimal prej 1 milion lekësh në vit vetëm nga mospagesa e taksave.

Duke folur për garancitë, CEO i SIGAL siguroi se këto fonde janë 100% të sigurta, pasi investohen në bono thesari të qeverisë.

“Paratë mbeten të investitorit dhe nuk humbin kurrë. Madje mund të trashëgohen nga familjarët nëse ndodh ndonjë fatkeqësi,” tha ai. Ponari theksoi gjithashtu se sot rreth 100 mijë persona janë pjesë e këtyre fondeve, shumica të punësuar në Shqipëri apo jashtë vendit, por numri mbetet ende i vogël. Sipas tij, fondi i pensioneve ofron edhe mundësi alternative investimi, më fitimprurëse se blerja e një banese, duke siguruar të ardhura mujore pa shqetësime dhe pa detyrime tatimore.

“Është një mënyrë për të jetuar me më shumë siguri dhe qetësi, sepse në fund të fundit, misioni ynë është që qytetarët të mos e ndiejnë humbjen financiare,” përfundoi Ponari.

Inovacion që bën diferencën



Inovacion që ndërton të ardhmen

SIGAL SJELL PRODUKTIN "TPL PLUS"

Në traditën zakonore shqiptare, ku gëzimet dhe hidhërimet shoqërohen shpesh me një gotë alkool, një sasi minimale nuk përbën domosdoshmërisht pakujdesi. Megjithatë, në rast aksidenti, çdo detaj merr rëndësi. Edhe një sasi e vogël alkooli mund të ndikojë në testin e frymëmarrjes dhe, sipas ligjit shqiptar, çdo nivel mbi zero konsiderohet ndikim alkooli edhe nëse drejtuesi nuk është i dehur dhe aksidenti nuk lidhet me përdorimin e alkoolit.

Në këto raste, kompanitë siguruese më parë kërkonin kthimin pas të dëmit të paguar, përmes padive të regresit.

SIGAL INSURANCE GROUP ka vendosur të veprojë ndryshe, jo për të gjitha rastet. Me produktin "TPL Plus", kompania ndjek shembullin e disa vendeve europiane dhe ofron mbulim për dëmet materiale, në rastet kur drejtuesi ka konsumuar sasi minimale alkooli – deri në 0.5 mg/L.

Nëse drejtuesi ka shkaktuar aksident dhe është mbajtës i kontratës TPL Plus, që kushton vetëm 3,000 Lekë në vit, SIGAL mbulon dëmet deri në 1 milion Lekë. Modeli është i ngjashëm me atë që aplikohet në disa vende evropiane:

Në Gjermani mbulohen dëmet nën 0.5 promilje pa shenja paaftësie; në Francë, kufiri është 0.3 promilje; në Austri dhe Zvicër, mbulimi përfshihet si klauzolë shtesë në KASKO për nivele nën 0.3 promilje.

Falë SIGAL për herë të parë në Shqipëri, për nivele alkooli nën 0.5 mg/L, mbulohen dëmet materiale deri në 1 milion Lekë.

BOTA DIGJITALE E SIGAL

Në një botë që po ndryshon çdo ditë, siguria është bërë domosdoshmëri.

Teknologjia po transformon mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe komunikojmë dhe sot, edhe sigurimet kanë hyrë në një epokë të re: epokën digjitale.

SIGAL INSURANCE GROUP, kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, po udhëheq këtë transformim përmes një game të gjerë shërbimesh dhe produktesh digjitale që e bëjnë jetën më të lehtë, më të sigurt dhe më të parashikueshme.

Në Sigal.com.al, çdo klient mund të:

- **Sigurojë pronën, makinën, udhëtimin apo jetën pa dalë nga shtëpia;**
- **Akcesojë dokumentet dhe pagesat në kohë reale;**
- **Kursejë për të ardhmen përmes Fondeve të Pensioneve Private;**
- **Përfitojë mbështetje dhe asistencë 24/7, kudo që ndodhet.**

Transformimi digjital i SIGAL-it nuk është vetëm një hap përpara në teknologji, por një angazhim për më shumë transparencë, shpejtësi dhe siguri për çdo qytetar.

Në një kohë kur gjithçka ndryshon me ritme të shpejta, SIGAL mbetet garancia e qëndrueshmërisë.





PËRGJEGJËSI SOCIALE

SIGAL.PRANË NËNAVE DHE FËMIJËVE, ME KRYQIN E KUQ TË ANGAZHUAR PËR PËRGJEGJËSI DHE KUJDES SOCIAL

Në prag të festave të fundvitit, SIGAL Insurance Group, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, Dega Tiranë, organizoi një takim të veçantë me fokus gratë dhe fëmijët, duke dhënë një mesazh të fortë solidariteti, kujdesi dhe përgjegjësie sociale.

Të pranishme në aktivitet ishin znj. Alma Totokoçi, Zëvendësdrejtoresh e Përgjithshme e SIGAL Insurance Group, si dhe znj. Xhulieta Mucollari, Drejtore e Kryqit të Kuq, Dega Tiranë, si edhe gra dhe fëmijë të familjeve në nevojë.

Për këtë fundvit, SIGAL dhuroi një kombinim me vlerë dhe kuptim të drejtpërdrejtë për familjet përfituese: karta check-up-i për gratë dhe fëmijët, karta shpenzimesh të parapaguara për përdorim në një rrjet supermarketesh në Shqipëri, si dhe lodra për fëmijët, për ta bërë fillimin e Vitit të Ri më të bukur për familjet e pranishme në aktivitet.

Gjatë aktivitetit, nënat u asistuan edhe nga teknikët e SIGAL për t'u lidhur me aplikacionin e Teleshëndetit, i njohur si "doktori telefonik".

Ky shërbim u mundëson grave dhe fëmijëve konsultë mjekësore falas 24/7, me telefon ose me kamera, përveç check-up-it falas dhe shërbimeve shëndetësore me ulje nga 30 deri në 50 për qind në rrjetin e spitaleve private më prestigjioze në Tiranë, me të cilët SIGAL Insurance Group bashkëpunon.

Znj. Alma Totokoçi uroi të gjithë për festat e fundvitit dhe theksoi se ky gjest është simbolikë e vogël e vetëdijesimit për rolin dhe përgjegjësinë sociale që SIGAL mban ndaj shoqërisë. Znj. Totokoçi u përcollti një mesazh solidariteti dhe mbështetje në emër edhe të kompanisë grave dhe nënave të pranishme në takim.

Nga ana e saj, znj. Xhulieta Mucollari falënderoi SIGAL për ndihmën konkrete dhe për ndihmën dhe kujdesin e vazhdueshëm në fushatat ndihmëse të Kryqit të Kuq. Znj. Mucollari vlerëoi bashkëpunimin dhe kontributin e pandërprerë të



SIGAL Insurance Group në mbështetje të shtresave në nevojë. SIGAL Insurance Group vlerëson lart përgjegjësinë sociale si një nga shtyllat kryesore të misionit të saj, duke u konfirmuar si kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në rajon, gjithmonë pranë njerëzve dhe nevojave reale të tyre. SIGAL, edhe më herët, në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit dhe në përvjetorin e Kryqit të Kuq, pati kontribuar në organizimin e mbrëmjes gala, duke krijuar një atmosferë të veçantë përmes Orkestrës së Harqeve SIGAL, si një tjetër shprehje e angazhimit të kompanisë për të mbështetur jetën sociale, kulturore dhe njerëzore të komunitetit.



PANAIRI I 31-TË NDËRKOMBËTAR I TIRANËS ÇEL SIPARIN, SIGAL INSURANCE GROUP PJESËMARRËS

Në Shqipëri është hapur Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, ku institucione dhe kompani nga vende të ndryshme po prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre në disa sektorë ekonomikë.

Panairi organizohet nga zyra e Klik Ekspo Group and Tirana International Fair dhe do të vazhdojë deri më 8 nëntor.

Si kompania më e madhe e sigurimeve në rajon, me tetë kompani në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut, pjesëmarrëse me stendën e saj do të jetë edhe SIGAL Insurance Group.

SIGAL Insurance Group do t'i sjellë këtij panairi përvojën 26-vjeçare në tregun e sigurimeve, një familje të gjerë produktesh novatore dhe ato të traditës, si në sigurimet e

Jetës dhe në ato të Jo-Jetës.

Këto oferta mbulojnë më së miri risqet financiare për individin dhe bizneset shqiptare.

Po ashtu, si pjesë e familjes SIGAL IG, në panair do të ekspozohen edhe mundësitë e shkëlqyera të investimit me përfitueshmëri të lartë në SIGAL Invest dhe zgjidhjet e investimit në kollonën e tretë të pensioneve private.

Pjesë e panairit janë dhjetëra kompani nga sektorë të ndryshëm nga Shqipëria, Turqia, vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, me fokus fushën e ndërtimit, energjisë, industrisë së rëndë dhe të lehtë dhe sektorë të tjerë, ku spikat edhe sektori financiar.

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit: **SIGAL NË MBRËMJEN GALA, ORKESTRA E HARQEVE SIGAL DHE DHURATA**

Në 104-vjetorin e themelimit të Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, Kryqi i Kuq Shqipëri zhvilloi një mbrëmje të veçantë gala, nën drejtimin e këngëtares dhe moderatores së njohur, Marsela Çibukaj. Aktiviteti synonte vlerësimin e mijëra vullnetarëve që çdo vit i shërbejnë komunitetit me përkushtim dhe profesionalizëm.

Edhe kete vit, SIGAL INSURANCE GROUP ishte pjesë e këtij aktiviteti. Kompania kontribuoi në mënyrë simbolike dhe domethënëse me interpretimin e disa pjesëve muzikore nga Orkestra e Harqeve SIGAL e drejtuar nga Mjeshtri i Madh Ermir Dizdari, e cila këtë vit shënon 12 vjet aktivitet të pandërprerë, duke i dhënë mbrëmjes nota të larta artistike dhe emocione të bukura.

SIGAL Insurance Group dhuroi gjithashtu dhjetëra karta check up-i falas të dedikuara për nëna dhe fëmijë, si një kontribut konkret për parandalimin e sëmundjeve. Kompania e konsideron diagnostikimin e hershëm si “armën e fitoreve të sigurta” për një shoqëri të shëndetshme, sepse shëndeti mbetet pasuria më e çmuar që kemi.

Vullnetarizmi dhe përvoja e gjatë e Kryqit të Kuq u nderuan me një program artistik të pasur: grupi i balerinave të Shkollës së Baletit, një balet klasik në çift nga primobalerinët e TOB Adela dhe Anxhelo Muçollari, si edhe performanca vokale të ngrohta dhe plot ndjeshmëri të interpretuara nga Marsela Çibukaj, e shoqëruar nga kitaristi nga Kosova, Berat Këpuska.



Po kaq frymëzuese ishin edhe mesazhet e forta në fjalët përshëndetëse të presidentit të Kryqit të Kuq Shqipëri dhe të vullëtares nga Ukraina, znj. Samolenko, e cila, ndonëse vetëm tre vjet në Shqipëri, mbajti një fjalim me një shqipe të përsosur.

Me pjesëmarrjen në këtë mbrëmje, SIGAL forcon edhe një herë rolin e saj si kompani që ushtron me seriozitet përgjegjësinë sociale dhe që e kupton qartë ndikimin e saj pozitiv në shoqëri, si kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në rajon.

ORKESTRA E SIGAL KORR SUKSES NË “TAKIMIN KOMBËTAR TË ORKESTRAVE TË HARQEVE” NË ELBASAN



Elbasani u kthye në kryeqendrën e muzikës klasike më 15 tetor, me hapjen e edicionit të dhjetë të “Takimit Kombëtar të Orkestrave të Harqeve”, që u zhvillua në teatrin “Skampa” dhe zgjati deri më 17 tetor. Ky aktivitet prestigjioz mbledhi orkestra dhe ansamble nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe rajonit, si Elbasani, Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora, Fieri, Berati e Ulqini.

Mes pjesëmarrësve spikati Orkestra e SIGAL, e cila u vlerësua me dy çmime speciale:
Çmimin e Publikut për Orkestrën më të Pëlqyer,
dhe Çmimin Special për Interpretim me Nivel të Lartë Artistik.

Në jurinë e këtij edicioni morën pjesë personalitete të njohura të muzikës shqiptare si Edmond Tullumani, Pacalim Zef Pavaci dhe Teuta Toska, të cilët vlerësuan nivelin artistik të lartë dhe interpretimin emocional të orkestrave pjesëmarrëse.

Ky sukses shënon një tjetër arritje për Orkestrën e SIGAL, duke dëshmuar se pasioni dhe përkushtimi ndaj artit muzikor vazhdojnë të shpërblehen me duartrokitje dhe vlerësime të merituar.



MARRËVESHJA: 5600 FËMIJË FUTBOLLISTË NËN MBROJTJEN E SIGAL

Presidenti i SIGAL Insurance Group, z. Avni Ponari, dhe kryetari i Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, z. Krenar Alimehmeti, nënshkruan një marrëveshje njëvjeçare bashkëpunimi në mjediset e Federatës Shqiptare të Futbollit.

Nga kjo marrëveshje, 5,600 fëmijë futbollistë, djem dhe vajza, që luajnë brenda qarkut të Tiranës, do të përfitojnë kontrollë mjekësore të rekomanduara dhe siguracion për dëmtimet sportive në një paketë të përbashkët, e cila ofrohet si gjysmësponsorizim nga SIGAL Insurance Group.

Marrëveshja u shoqërua me një ceremoni të rastit, ku mbajtën fjalët e tyre përfaqësues të FSHF-së, SIGAL Insurance Group-it dhe SHRFT-së.

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka, përshëndeti marrëveshjen duke e cilësuar atë si një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të standardeve dhe cilësisë së futbollit të moshave. Ai theksoi se kjo nismë përbën një moment historik, pasi tashmë fëmijët nuk do të jenë më të ekspozuar ndaj rastësive apo fatit, por do të kenë një mbrojtje financiare të siguruar për shëndetin e tyre.

CEO i SIGAL Insurance Group, z. Avni Ponari, në fjalën e tij çmoi lart marrëveshjen dhe shprehu gatishmërinë për ta zgjeruar më tej bashkëpunimin e suksesshëm me Federatën Shqiptare të Futbollit, drejtimin e së cilës e konsideroi shumë novator dhe ambicioz për standardet më të mira në të gjitha drejtimet. Ai e vlerësoi këtë nismë



si një hap me rëndësi të jashtëzakonshme, duke theksuar ndikimin e saj konkret në jetën e sportistëve të rinj dhe të familjeve të tyre. Në fjalën përshëndetëse, z. Ponari kujtoi se shpesh prindër dhe fëmijë i janë drejtuar kompanisë për ndihmë pas dëmtimeve, ndërsa tashmë, falë marrëveshjes së re me Federatën e Futbollit, kjo nevojë shmanget përmes një zgjidhjeje të strukturuar dhe dinjitoze. Sipas tij, sportistët e rinj nuk do të varen më nga ndihmat apo rastësitë, as nga mëshira institucionale, por do të ndihen të mbrojtur dhe krenarë për kontratat e tyre të sigurimit, të cilat u garantojnë mbështetje në rast dëmtimi, si në çdo vend tjetër ku sporti trajtohet me profesionalizëm. Ponari nënvizoi se një dëmtim serioz, si p.sh. një thyerje këmbë që mund të kushtojë deri në pesë mijë euro. Dëmtime si këto, jo të pazakonta në sporte me përballje, përbën një barrë të menjëhershme dhe të papritur për çdo prind. Pikërisht për këtë arsye, ai falënderoi Federatën dhe të gjithë bashkëpunëtorët që mundësuan këtë marrëveshje, duke e



konsideruar atë si një model që duhet të zgjerohet edhe më tej në vitet në vijim, dhe për këtë shprehu edhe përkushtimin e plotë nga ana e kompanisë së tij.

Ardian Haçi, sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Rajonale të Futbollit, e konsideroi këtë projekt shumë efikas, pasi plotëson tre kriteret e rëndësishme: çmimin e ulët të paketës, karakterin jodetyrues dhe përfitimet konkrete e praktike për aktivitetin sportiv të fëmijëve dhe familjarëve të tyre.

Marrëveshja përbën një hap të rëndësishëm drejt mbrojtjes dhe mirëqenies së sportistëve të rinj, duke vendosur standarde të reja sigurie në futbollin e moshave. SIGAL IG është sponsor premium i kombëtares kuqezi dhe bashkërrugëtare e sukseseve prej më shumë se një dekade; po ashtu, është sponsor edhe i kampionatit vendas, Abissnet Superiore, duke ndjekur shembujt botërorë të gjigantëve të sigurimeve që mbështesin dhe investohen drejtpërdrejt për standarde të larta në sport.

“GIRO D’ITALIA”, SIGAL ME SHPEJTËSINË E KAMPIONËVE TË ÇIKLIZMIT

“Giro d’Italia” është një nga garat më të rëndësishme dhe më prestigjioze të çiklizmit në nivel botëror.

Për tre ditë të muajit maj, muaj kur historikisht kjo xhiro është organizuar, rrugët e Shqipërisë ishin të mbushura me kureshtarë, sportdashës, amatorë të çiklizmit, turistë dhe përplot biçikleta e çiklistë të njohur ndërkombëtarisht.

Në këtë organizim të niveleve më sipërore të sportit botëror, nuk kishte se si të mungonte SIGAL, lider i tregut të sigurimeve në vend.

SIGAL është tashmë i kudogjendur në mbështetjen e aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, që e lartësojnë me përvojë dhe imazh paraqitjen e vendit dhe të sportit shqiptar në mediat botërore.

Si një mënyrë për t’i kujtuar publikut leadershipin e plotë të kompanisë në tregun e sigurimeve e veçmas të produktet e shëndetit, SIGAL bëhet pjesë e ritmit të kampionëve të dyrrotakëve dhe sponsorizon fazat e etapës së parë në Shqipëri.

SIGAL mbështet fazat e para shqiptare të etapës së parë dhe u kujton klientëve se shëndeti, e veçanërisht siguri nga aksidentet sportive i jep pushtet të pakufijshëm pasionit për çdolloj sporti.

Me ritmin e kampionëve të çiklizmit dhe me sigurinë e kampionëve të sigurimeve, pasioni për sport mund të marrë pushtet të plotë.





SIGAL INVEST NË MARATONËN E TIRANËS, ÇDO HAP PËR SOLIDARITET DHE SHPRESË

Këtë vit, SIGAL Invest u bë pjesë e Maratonës së Tiranës, duke e kthyer këtë aktivitet sportiv në një moment sensibilizues përmes mbështetjes ndaj Organizatës Down Syndrome Albania. Përmes solidaritetit dhe përfshirjes publike, u përcoll një mesazh i fortë për fëmijët dhe familjet që preken nga Sindroma Down, se çdo hap përpara ka vlerë kur bëhet me zemër.

Maratona e Tiranës na kujtoi se fuqia e vërtetë nuk matet me kohë, por me dashuri dhe përkushtim.

SIGAL Invest ishte krenare të mbështeste këtë kauzë, duke treguar se çdo hap drejt finishit është një hap drejt një shoqërie më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse.

Le të ecim së bashku, me shpejtësinë dhe qëndrueshmërinë e maratonës, në këtë rrugëtim për një botë ku çdo zë dëgjohet dhe çdo ëndërr ka vendin e saj.

SIGAL Invest, sponsor krenar i Maratonës së Tiranës 2025.

PRISHTINA KRENOHET ME PONARIN

Komuna e Prishtinës i jep Çmimin e Mirënjohjes CEO-s së SIGAL

Ditën e mërkurë, Komuna e Prishtinës, në një pritje ceremoniale të kryesuar nga kryetari i Komunës, z. Përparim Rama, në mjediset e Komunës së kryeqytetit të Kosovës i shprehu mirënjohjen për kontributin e tij në jetën ekonomike, shoqërore dhe sportive të kryeqytetit dhe të Kosovës, z. Avni Ponari, CEO-s së SIGAL.

Kryetari i Komunës, z. Përparim Rama, për këto kontribute, në emër të qytetarëve të kryeqytetit të Kosovës i dha Çmimin e Mirënjohjes CEO-s së SIGAL, z. Avni Ponari. Ponari është themeluesi i SIGAL, kompania e sigurimeve që operon në tre vende të rajonit, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut. Në Kosovë, përmes SIGAL, z. Ponari ka qenë shumë i pranishëm në disa aktivitete shoqërore, kulturore e sidomos jetën sportive, ku investoi në një ndër projektet sportive më fituese në Ballkan, SIGAL Prishtinën e basketbollit.

Skuadra kryeqytetase ka shënuar numrin jubilar të 40 trofeve në histori, pjesa më e madhe e të cilave të arritura në këto 21 vjet bashkëpunim me SIGAL, mes të cilave kampionate, kupa dhe superkupa të Kosovës, si edhe 3 liga Ballkanike.

“Avni Ponari basketbollin nuk e pa si lojë, por si një vullnet të përbashkët, dhe prej atyre që e shihnin nga tribuna, krijoi një popull që me të krehohet.



Për këtë rrugëtim të jashtëzakonshëm, në shenjë falenderimi sot i dhamë mrënjohje në emër të Kryeqytetit.

Prishtina krenohet me ty!”, shkroi kryekomunari i Prishtinës në fejsbukun e tij zyrtar pas pritjes ceremoniale.

Ponari, përmes SIGAL Group, hyri në tregun kosovar në vitin 2003, vetëm katër vite pasi themeloi kompaninë në Shqipëri. Me dy kompani sigurimi – një për jo-jetën dhe një për sigurimet e jetës – SIGAL u bë një emër kyç në tregun e sigurimeve në Kosovë.

Brenda pak vitesh, kompania u konsolidua si një nga liderët e sektorit, duke ruajtur një pjesë të qëndrueshme të tregut dhe duke ofruar shërbime me cilësi të lartë. Sot, rrjeti i SIGAL numëron mbi 2000 punonjës dhe agjentë, me mbi 1000 zyra aktive në tre shtete – Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.

SË BASHKU NË ROZË: GRATË NË SIGAL MK PJESE E SIGAL INSURANCE GROUP E SHËNUAN TETORIN ROZË



Si një kompani sigurimesh që kujdeset për shëndetin dhe mirëqenien e klientëve dhe të punësuarve, në SIGAL MK pjese e SIGAL Insurance Group me krenari e shënuam Tetorin Rozë – muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.

Organizuam një panel-diskutim me gratë e kompanisë, i fokusuar në:

- rëndësinë e kontrollit të rregullt shëndetësor,
- histori personale dhe përvoja të ndara,
- ndërtimin e një kulture të kujdesit dhe mbështetjes në vendin e punës.

Me detaje rozë, biseda të hapura dhe këshilla profesionale, treguam se parandalimi është arma më e fuqishme.

Këshilla dhe konsulta shëndetësore falas gjatë tetorit

Si pjesë e angazhimit tonë për shëndetin, këtë muaj u ofrojmë të gjithë përdoruesve të sigurimit shëndetësor konsulta dhe këshilla falas nga profesionistë shëndetësorë, si një kujtesë se veprimi në kohë mund të shpëtojë jetë.

Vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare



RENDITJA VJETORE E SEE NEWS: SIGAL NË SHQIPËRI, SIGAL NË KOSOVË DHE SIGAL NË MAQEDONI TË VERIUT NË 100-SHEN E PARË TË EVROPËS JUGLINDORE



SEE News, South East Europe News, rrjeti profesional i lajmit të specializuar në analizë biznesi, raportime krahasuese dhe renditje mbi kompanitë, qeveritë dhe investimet rajonale në Evropën Juglindore, publikoi së fundmi edhe renditjen e kompanive më të mëdha në rajon për vitin 2024, në edicionin e tetëmbëdhjetë të saj. Në "SEE TOP 100" për vitin 2024, ku renditen kompanitë, bankat dhe siguruesit më të mëdhenj të 11 shteteve të Evropës Juglindore, SIGAL Insurance Group përfaqësohet me të tre degët e sigurimeve në rajon, SIGAL në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut.

Dega e SIGAL në Shqipëri renditen në vendin nr. 51/100, e rritur me dy vende nga viti paraardhës, me 58.4 milionë euro prime të

shkruara bruto, 4.19% rritje nga viti paraardhës dhe 4.1 milionë euro fitim, e rendit SIGAL në Shqipëri si kompaninë e parë të sigurimeve në vendin tonë.

Në Top 100-shen e siguruesve të 11 vendeve të Evropës Juglindore bën pjesë edhe SIGAL në Maqedoninë e Veriut, kompania radhitet në vendin nr. 81/100, e rritur me shtatë vende nga viti paraardhës. Ndërsa SIGAL në Kosovë radhitet në vendin nr. 92/100, duke ruajtur pozita të pandryshuara.

Kjo renditje konfirmon pozitat tërësore të SIGAL Insurance Group si kompania më e madhe e sigurimeve në rajonin Shqipëri-Kosovë-Maqedoni e Veriut.

A blurred background image of a desk with various office supplies. In the foreground, a white sheet of paper contains a business report. The report includes a bar chart with blue and black bars, a line chart with blue lines and circular markers, and a pie chart with blue and dark blue segments. A wooden pencil lies diagonally across the line chart. A blue rectangular box with white text is overlaid on the center of the image.

Tregu i Sigurimeve

AMF publikon raportin vjetor 2025:

SIGAL PAGUAN 26.02% TË DËMEVE TOTALE TË TREGUT TË SIGURIMEVE

Sipas raportit vjetor 2025 të AMF, për periudhën janar–dhjetor 2025, SIGAL në tregjet jetë dhe jo-jetë të marra së bashku paguan 26.02% të dëmeve, me 20,444 përfitues konkretë përgjatë vitit.


Në sigurimet e jetës, kompania paguan 41.84% të dëmeve, ose 133,915,000 Lekë (afërsisht 1.39 milionë euro) nga 320,070,000 Lekë (afërsisht 3.31 milionë euro) të totalit të tregut.

Në sigurimet jo-jetës, SIGAL paguan 25.38% të dëmeve, ose 2,001,800,000 Lekë (afërsisht 20.7 milionë euro) nga 7,887,627,000 Lekë (afërsisht 81.6 milionë euro) të totalit të tregut me 8 operatorë.

Mbi 22.09 milionë euro dëme, ose përkatësisht 2,135,715,000 Lekë u paguan nga SIGAL përgjatë vitit 2025.

Tregu i dëmeve të paguara të sigurimeve të jetës dhe jo-jetës janar-dhjetor 2025

Sipas botimit të Autoritetit të Mbikëzyrjes Financiare




Në siguracionet e tjera:

SIGAL paguan 1,390,355,000 Lekë (afërsisht 14.38 milionë euro) dëme në sigurimet motorike, nga të cilat:

- 504,617,000 Lekë (afërsisht 5.22 milionë euro) në sigurimet e Kartonit Jeshil.
- 95,704,000 Lekë (afërsisht 0.99 milionë euro) në sigurimet kufitare.
- 388,169,000 Lekë (afërsisht 4.01 milionë euro) në sigurimet KASKO.


Sigurimet
Motorike



Kompania pagoi 41.98% të dëmeve totale të tregut në siguracionet e pronës nga fatkeqësitë natyrore, përkatësisht SIGAL pagoi 241,936,000 Lekë (afërsisht 2.50 milionë euro) për dëmet në pronë.

- SIGAL pagoi 354,864,000 Lekë, 47.87% të totalit të tregut, për aksidente dhe shëndet.
- SIGAL pagoi 70.9% të totalit të tregut, përkatësisht 215,150,000 Lekë për shëndetin në udhëtim.
- SIGAL pagoi 306,959,000 Lekë, 46.52% dëme të tregut të paguara në sigurimin e sëmundjeve


Sigurimi
Pronës




Pagesa e shpejtë e dëmeve, brenda 14 ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit, me korrektesë dhe përpikëri, sipas kontratave në fuqi dhe legjislacionit, mbetet filozofi e punës së kompanisë.

Përlllogaritja e dëmeve bëhet sipas legjislacioni dhe një rregulloreje të qartë dhe kompania nuk ka deri më tani asnjë ankesë zyrtare, as në zyrat e kompanisë dhe as në Byronë e Ankesave pranë AMF, për mënyrën e trajtimit apo përlllogaritjes së dëmit, ca më pak për refuzim pagesash të tyre.

Sigurimi
Shëndetit



SIGAL KOSOVA PAGUAN 15.01% TË DËMEVE TOTALE NË INDUSTRINË E SIGURIMEVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2025



Sipas raportit zyrtar të Bankës Qendrore të Kosovës, në industrinë e sigurimeve të Kosovës me 12 kompani operuese në jojetë dhe 2 në sigurimet e jetës, SIGAL, paguan 15.01% të dëmeve totale.

Përkatësisht, SIGAL KOSOVA paguan thuhetse 1 në 3 dëme të jetës, 31.1%, ose 598,821 euro dëmshpërblime në sigurimet e jetës, nga 1,925,469 euro që pagoi e gjithë industria. Në sigurimet e jojetës, SIGAL KOSOVA pagoi 14.63% të dëmeve totale, ose 12,384,416 euro përgjatë vitit 2025. Industria e sigurimeve të jojetës, në total, pagoi 84,623,379 euro.

12,983,885 euro pagoi në jetë dhe jojetë SIGAL, si dëmshpërblime në tregun e sigurimeve të Kosovës.

15.01% të dëmeve totale, jetë dhe jojetë të marrë së bashku, në një treg me 12 operatorë, në Kosovë i paguan SIGAL KOSOVA.

Kjo shifër ruan fuqinë paguese dhe korrektesën që SIGAL ka me klientët e saj edhe në Shqipëri, ku paguan 26.02% të dëmeve totale dhe në Maqedoni të Veriut, ku paguan 10.92% të dëmeve totale të tregut.

SIGAL MAQEDONIA E VERIUT PAGUAN 11.6% TË DËMEVE TË TREGUT

Sipas të dhënave zyrtare të tregut të sigurimeve të Maqedonisë së Veriut, të përpunuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në 9 muajt e parë të vitit 2025, SIGAL Maqedonia e Veriut zotëron 12.47% të tregut të sigurimeve të jojetës.


Në aspektin e aktivitetit kontraktual, SIGAL ka lidhur 200,777 kontrata sigurimi jojete, ndërkohë që i gjithë tregu i jojetës numëron 1,633,565 kontrata, duke vijuar konsolidimin e rrjetit të klientëve.

Tregu i sigurimeve të jetës

Në segmentin e sigurimeve të jetës, SIGAL Maqedonia e Veriut ka shënuar një pjesë tregu prej 10.25%, duke reflektuar rritje të qëndrueshme dhe besim në produktet afatgjata të sigurimit të jetës. Gjatë kësaj periudhe, SIGAL ka lidhur 1,618 kontrata sigurimi jete, në një treg që në total numëron 23,275 kontrata, duke forcuar gradualisht praninë e saj në këtë segment strategjik.

Pjesa e tregut total të sigurimeve

Duke kombinuar sigurimet e jojetës dhe të jetës, SIGAL Maqedonia e Veriut zotëron 10.39% të tregut total të sigurimeve, një tregues i qartë i pozitës së konsoliduar të kompanisë dhe i strategjisë së balancuar ndërmjet dy segmenteve kryesore të industrisë.



Pagesa e dëmeve

Pagesa e dëmeve mbetet një nga treguesit më të rëndësishëm të seriozitetit dhe aftësisë financiare të një kompanie sigurimi.

Në sigurimet e jojetës, SIGAL ka paguar 503,254,000 denarë dëme (8.18 milionë euro), nga një total tregu prej 3,963,835,000 denarë (64.41 milionë euro).

Në sigurimet e jetës, SIGAL ka paguar 55,155,000 denarë dëme (0.90 milionë euro), ndërsa i gjithë tregu ka paguar 853,026,000 denarë (13.86 milionë euro).

Këto shifra dëshmojnë jo vetëm peshën reale të SIGAL në treg, por edhe angazhimin e vazhdueshëm për përmbushjen korrekte dhe në kohë të detyrimeve ndaj klientëve.

Këta tregues e pozicionojnë kompaninë si një partner afatgjatë dhe të qëndrueshëm për individët dhe bizneset në Maqedoninë e Veriut.


AMF: FONDI SIGAL VIJON KRYESIMIN E TREGUT TË FONDEVE PRIVATE TË PENSIONEVE NË VLERË ASETESH

AMF publikoi raportin 9-mujor për ecurinë e fondeve private të pensione: SIGAL mban kryesimin në tregun e pensioneve private për 9-mujorin 2025, në vlerën neto të aseteve. Sipas raportit të AMF, tregu i fondeve të pensioneve private në tërësi ka vijuar rritjen e qëndrueshme gjatë periudhës janar–shtator 2025.

Sipas të dhënave zyrtare të AMF, në aktivitet ushtruan veprimtarinë e tyre shtatë fonde pensioni, ndërsa asetet neto totale të tregut arritën në 14.357,03 milionë lekë (rreth 148.7 milionë euro) më 30.09.2025.

Kjo shifër përfaqëson një rritje prej 11.55%, ose 1.486 milionë lekë më shumë se në fund të vitit 2024. Në këtë treg në rritje, SIGAL konfirmon pozicionin e vetë si kryesues, përkatësisht me këto të dhëna: SIGAL MAX Pension kryeson me 17,791 anëtarë dhe një vlerë neto asetesh prej 3,522,200,000 lekësh ndërsa SIGAL Pro Pension ka 633 anëtarë dhe 60,600,000 lekë asetet neto. Në total, SIGAL zotëron 37.99% të vlerës neto të aseteve të tregut, ndërsa SIGAL Pro mban 0.65%.

Besimi i klientëve, si dhe administrimi i matur dhe serioz, kanë ruajtur norma të qëndrueshme dhe të larta kthimi, duke forcuar më tej besueshmërinë e fondit dhe kënaqësinë e klientëve. Fondi i Pensioneve SIGAL, si pjesë e familjes së SIGAL Insurance Group, vijon me të njëjtën filozofi ndaj klientëve: si të qenit më e madhja përmes besimit dhe korrektesës.






Të dhëna Financiare 2025

TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL

Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2022	2023	2024	2025
SIGAL AL	57,009,000	64,790,000	71,394,000	78,890,000
SIGAL KS	18,513,000	21,383,000	25,288,000	27,585,000
SIGAL MKV	23,205,000	26,224,000	29,546,000	36,225,000
Grupi	98,727,000	112,397,000	126,228,000	142,700,000

Lloji i produktit	AL	KS	MK	Grupi
Pasuri	15,338,794	5,148,310	5,433,697	25,920,801
Motorike	40,803,532	13,288,748	20,195,948	74,288,228
Shëndet & AP	7,682,046	5,015,470	4,242,298	16,939,815
Jetë	7,695,185	3,844,640	5,834,033	17,373,858
Marinë	807,629	288,165	518,660	1,614,454
Risigurime	70,143	0	0	70,143
Pension	6,492,218	0	0	6,492,218
TOTAL	78,889,547	27,585,333	36,224,637	142,699,517



RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas Standarteve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar per vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2025

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigal Insurance Group SHA:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Insurance Group SHA ("Shoqëria") dhe të filialave të saj (së bashku 'Grupi') janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 140, datë 7 nëntor 2025, për shtyrjen e zbatimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17 (IFRS 17) 'Kontratat e Sigurimit'.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit përfshijnë:

- pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025;
- pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara, të cilat përfshijnë informacione domethënëse për politikën kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të këtij raporti.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me kërkesat etike të Ligjit “Për auditimin ligjor dhe profesionin e audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (Ligji për Auditimin Ligjor) që janë të zbatueshme për auditimet e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri dhe Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (Kodi BSNEK) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare për njësitë ekonomike me interes publik në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me Ligjin për Auditimin Ligjor dhe kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me kërkesat e Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 140, datë 7 nëntor 2025, për shtyrjen e zbatimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17 (IFRS 17) ‘Kontratat e Sigurimit’, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësisë.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e veprimtarisë, nëse është rasti, përveç atyre rrethanave kur drejtuesit synojnë që Grupi të likuidohet apo të ndërpresë veprimtarinë, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë të fitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional përgjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomalë materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomalë si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar nga procesi i auditimit, nëse ka një pasiguri domethënëse në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri domethënëse, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese përkatëse të pasqyrave financiare të konsoliduara ose, në rast se shënimet shpjeguese përkatëse nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e mbledhur gjatë procesit të auditimit deri në datën e këtij raporti. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte të ardhshme mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Grupit.
- Planifikojmë dhe kryejmë auditimin e grupit për të marrë evidencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme në lidhje me informacionin financiar të njësisë ekonomike apo aktiviteteve tregtare brenda grupit si bazë për të mbështetur shprehjen e një opinionit për pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për të udhëhequr, mbikëqyrur, dhe për të rishikuar punën e kryer të auditimit për qëllime të auditimit të grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm në lidhje me opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që konstatojmë gjatë procesit të auditimit.

Jonid Lamllari
Jonid Lamllari
 Tiranë, Shqipëri
 15 qershor 2026



SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	8	384,994	357,683
Depozita me afat me bankat	9	11,357,307	11,226,029
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	10	3,572,834	3,415,996
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë	11	837,557	641,349
Shpenzime të shijes së kontratave	12	98,172	89,602
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	13	1,426,898	1,246,746
Aktive të risigurimit	14	1,594,795	2,265,167
Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	15	1,180,423	964,357
Tatim fitimi i arkëtueshëm		4,059	24,649
Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale dhe aktive me të drejtë përdorimi	16	1,739,059	1,346,451
Pasuri e investuar	17	1,029,020	-
Aktive të tjera	18	1,138,472	558,981
Totali i aktiveve		24,363,590	22,137,010
Detyrimet			
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme	19	8,699,233	9,198,389
Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e paguar	20	6,792,823	5,984,265
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe e risigurimit	21	813,320	668,356
Tatim fitimi për t'u paguar		213,799	10,263
Detyrime të qirase	22	528,636	138,121
Detyrime të tjera	23	851,900	438,121
Totali i detyrimeve		17,699,711	16,437,515
Kapitali			
Kapitali aksionar	24	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit		52,133	52,133
Rezerva për veprimtarinë e sigurimit	25	803,466	771,756
Rezerva përkthimi		(894,015)	(651,602)
Fitimi i mbartur		4,404,952	3,430,762
Totali i kapitalit që i përket aksionerëve të Shoqërisë mëmë		6,599,445	5,635,958
Interesi jo kontrollues		64,434	63,537
Totali i kapitalit		6,663,879	5,699,495
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		24,363,590	22,137,010

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga drejtuesit e Grupit më 29 maj 2026 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Avni Forster
Drejtor i përgjithshëm


Kliment Mersini
Drejtor i departamentit të
financës

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjithashumat janë në mijëleke, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	2025	2024
Prime të shkruara bruto	26	13,268,895	12,065,367
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara		(846,300)	(546,310)
Prime të shkruarane		12,422,595	11,519,057
Prime të shkruara ceduar risiguruesit		(1,723,338)	(1,490,090)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet pafituara	27	18,286	100,962
Të ardhurane nga veprimtaria e sigurimit		10,717,543	10,129,929
Të ardhura nga interesi		396,070	385,793
Të ardhura të tjera	28	967,946	354,505
Të ardhurane		12,081,559	10,870,227
Ndryshimi në detyrimet e kontratave të sigurimit për dëme		431,364	(1,217,990)
Ndryshimi në pjesën e risiguruesit në detyrimet e kontratave të sigurimit për dëme		(503,573)	478,504
Dëme të paguara		(4,657,572)	(4,172,471)
Dëme të paguara nga risiguruesit		515,673	367,721
Shpenzime për dëme neto		(4,214,108)	(4,544,236)
Shpenzime të marrjes në sigurim	29	(2,662,993)	(2,289,790)
Shpenzime administrative dhe marketingu	30	(2,296,611)	(2,393,163)
Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit	31	(397,666)	(497,852)
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit		(148,918)	(256,900)
Fitimi para tatimit		2,361,263	888,286
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	32	(372,966)	(148,061)
Fitimi i vitit		1,988,297	740,225
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që janë ose mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje</i>			
Matja me vlerë të drejtë investimeve AFS		(11,003)	-
Tatim i shtyrë		-	-
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese		(13,210)	(198,683)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		1,964,084	541,542
Fitimi që i përket:			
Aksionerëve e Shoqërisë mëmë		1,987,400	733,857
Interesi jo kontrollues		897	6,368
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që i përkasin		1,963,187	535,174
Aksionerët të Shoqërisë mëmë		897	6,368
Interesi jo kontrollues			

Shënimet në faqet 5 deri në 44 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital***(Të gjitha shumatat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva për veprimtarinë e sigurimit	R P
Gjendja më 1 janar 2024	2,232,909	52,133	710,153	
Fitimi i vitit	-	-		
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese	-	-		
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2024	-	-	-	
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	-	61,603	
Dividendë të paguar	-	-	-	
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek aksionerët	-	-	61,603	
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,232,909	52,133	771,756	(
Fitimi i vitit	-	-	-	
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese	-	-	-	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	-	31,710	
Dividendë të paguar	-	-	-	
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek aksionerët	-	-	31,710	
Gjendja më 31 dhjetor 2025	2,232,909	52,133	803,466	

Shënimet në faqet 5 deri në 44 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Rezerva e përkthimit	Fitim i mbartur	Kapitali që i përket aksionerëve të Shoqërisë mëmë	Interesi jo kontrollues	Totali
(652,919)	3,046,905	5,389,181	57,169	5,446,350
-	733,857	733,857	6,368	740,225
(198,683)		(198,683)		(198,683)
-	-	-	-	-
(198,683)	733,857	535,174	6,368	541,542
-	(61,603)	-	-	-
-	(350,000)	(350,000)		(350,000)
-	(411,603)	(350,000)	-	(350,000)
(851,602)	3,430,762	5,635,958	63,537	5,699,495
-	1,987,400	1,987,400	897	1,988,297
(42,413)	-	(42,413)	-	(42,413)
-	-	-	-	-
(42,413)	1,987,400	1,944,987	897	1,945,884
-	(31,710)	-	-	-
-	(981,500)	-	-	(981,500)
-	(1,013,210)	(981,500)	-	(981,500)
(894,015)	4,404,952	6,599,445	64,434	6,663,879

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.
Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare
(Të gjitha shumatat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2025	2024
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese			
Fitimiparatatimit		2,361,263	888,286
<i>Rregullimet</i>			
Amortizimi	16	260,325	212,907
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	31	143,017	205,916
Fitimi i përealizuar i investimeve në letra me vlerë të drejtë të mbajtura në fitim ose humbje gjatë vitit		(2,233)	3,319
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(6,889)	-
Të ardhura nga interesi		(396,070)	(385,794)
Shpenzime interesi		29,755	11,289
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		2,389,168	935,923
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese:</i>			
Llogaritë e arkëtueshme ngaveprimtarisë sigurimit		(323,169)	(228,879)
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		(216,066)	(38,082)
Aktive të risigurimit		670,372	(664,256)
Aktive të tjera		(588,058)	1,566
Detyrime ndaj risiguresve		(55,036)	(39,828)
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme		309,402	1,449,099
Detyrime të tjera		413,779	(11,259)
Tatim fitimi i paguar		(148,840)	(120,327)
Interes i paguar		(29,756)	(11,289)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		2,421,796	1,272,668
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese			
Flukse dalëse nga blerja e aktiveve afatgjata materiale Blerje të pronave të investimit	17	(212,146)	(155,529)
Flukse hyrëse nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(1,029,020)	-
Investime në depozita me afat me bankat		19,145	8,383
Maturime të investimeve të mbajtura me kosto të amortizuar		(125,744)	(861,097)
Flukset dalëse nga investimet në letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar		484,188	288,267
Interesa të marra		(807,885)	(438,795)
		363,420	369,963
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese neto		(1,308,042)	(788,808)
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë financiare			
Dividendë të paguar	24	(981,500)	(350,000)
Pagesa të qirasë		(82,384)	(98,244)
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë financiare neto		(1,063,884)	(448,244)
Rritje në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre neto		49,870	35,616
Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre		(22,559)	(69,398)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		357,683	391,465
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	8	384,994	357,683

Shënimet në faqet 5 deri në 44 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.

Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Insurance Group Austria SH.A, ("Shoqëria") dhe filialeve të saj (së bashku, "Grupi"), janë përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara janë paraqitur në Shënimin 3. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 përfshijnë Shoqërinë dhe filialet e saj (së bashku të referuara si 'Grupi' dhe individualisht si 'entitete në grup').

Shoqëria është e themeluar dhe e vendosur në Shqipëri që nga viti 1999 si shoqëri aksionare sigurimi në përputhje me ligjin nr. 8081, datë 7 mars 1996, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. 20863, datë 22 shkurt 1999. Shoqëria aktualisht është subjekt i ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" datë 4 korrik 2004 ("Ligji Shqiptar i Sigurimeve").

Gjatë vitit 2025, kompania mëmë ndryshoi nga UNIQA Österreich Versicherungen AG, Vjenë, Austri, në Sigal Business Center SHPK, e zotëruar 100% nga z. Avni Ponari, i cili është pronari përfundimtar kontrollues dhe përfitues i Shoqërisë. Shoqëria më parë njihet me emrin Sigal Uniq Group Austria SH.A.

Pas përfundimit të transaksionit, Shoqëria ndryshoi emrin e saj nga Sigal Uniq Group Austria Sh.A. në Sigal Insurance Group SH.A.

Veprimtaria kryesore: Aktivitetet kryesore të biznesit të saj përfshijnë ofrimin e shërbimeve të sigurimit për automjetet motorike, pronën, shëndetin, marinën dhe aviacionin, jetën dhe lloje të tjera të sigurimit. Grupi operon gjithashtu si një entitet menaxhues i fondeve të pensionit.

Vendndodhja e biznesit: Adresa e Shoqërisë është Blv. "Zogu I", nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Filialet kryesore operative dhe aktivitetet e tyre janë si më poshtë:

Veprimtarianë Shqipëri

Sigal Life Insurance Group SH.A. (100% e pronësisë së Sigal

2004, Grupi hyri në biznesin e sigurimit të jetës në Shqipëri duke krijuar Sigal Life SH.A, kapitali aksionar i së cilës aktualisht është 100% në pronësi të Shoqërisë.

Sigal Invest, Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të

Investimeve Kolektive (SHAFPPSIK) SH.A. (51% e pronësisë së Sigal Insurance Group sh.a.)

- është blerë më 31 mars 2011 nga AVEL Sh.p.k. Përqindja e interesave të pronësisë të zotëruara nga interesat jo kontrolluese është 49% dhe përqindja e të drejtave të votës që zotërohen nga interesat jo kontrolluese është e njëjtë me përqindjen e interesave të mbajtur të pronësisë.

Veprimtarianë Kosovë

Sigal Insurance Group SH.A. – Prishtinë (100% pronësie Sigal Insurance Group SH.A.)

është themeluar në vitin 2003, si degë e Sigal Uniq Group Austria SH.A. (tani Sigal Insurance Group sh.a) në territorin e Kosovës të administruar nga OKB. Licenca është lëshuar më 23 tetor 2003 nga Banka dhe Autoriteti i Pagesave të Kosovës (tani Banka Qendrore e Kosovës) dhe entiteti është regjistruar si degë e Uniq Group Austria SH.A (tani Sigal Insurance Group sh.a). Në vitin 2012, dega ndryshoi statusin e saj ligjor në filial.

Sigal Life Insurance Group SH.A. – Prishtinë (100% pronësi Sigal Insurance Group SH.A.)

është themeluar më 10 maj 2011 me qëllim të ushtrimit të biznesit të sigurimit të jetës në Kosovë.

Veprimtaria në Maqedoninë e Veriut

Sigal Insurance Group AD Skopje (99.94% e pronësisë së Sigal Insurance Group SH.A.) është themeluar më 15 prill 2004 si Sigal SHA - Shkup. Është e licencuar për të ofruar 13 klasa sigurimesh të jo-jetës. Linjat kryesore të veprimtarisë janë sigurimet e lidhura me mjetet motorike (MTPL, policat kufitare, kartoni jeshile), pasuri dhe aksidentet.

Sigal Life Insurance AD Skopje (100% pronësi e Sigal Insurance Group SH.A.)- u themelua më 29 qershor 2011 për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të jetës në Maqedoni.

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Përfaqësuesi i Shoqërisë është Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm. Këshilli Mbikëqyrës gjatë vitit 2025 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara është i përbërë nga:

Naim Hasa	Kryetar
Turgaj Demirel	Anëtar
Besnik Mustafaj	Anëtar

2. Bazat e përgatitjes

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 140, datë 7 nëntor 2025, i cili shtyn zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (“SNRF”) 17 “Kontratat e sigurimit” për shoqëritë e sigurimit, duke zbatuar konventën e kostos historike. Politikat kontabël të Grupit paraqiten në Shënimin 3.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në Lek Shqiptar (“ALL”), që është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveç nëse tregohet ndryshe.

Përkthimi i valutës së huaj

Transaksionet dhe gjëndjet

Aktivet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë (“BSH”) në fund të periudhës raportuese përkatëse. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit zyrtar të BSH-së në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje. Të gjitha fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, në zërin ‘Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit’. Përkthimi sipas kursit të fundvitit nuk aplikohet për zërat jo-monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo-monetarë që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, përfshirë investimet në kapital, përkthehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi zërat jo-monetarë të matur me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si fitim ose humbje nga vlera e drejtë.

Shoqëritë e Grupit

Rezultatet dhe pozicioni financiar i çdo njësie ekonomike të Grupit (monedha funksionale e asnjërës prej të cilave nuk është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste) përkthehen në monedhën e prezantimit si më poshtë:

- (i) aktivet dhe detyrimet për çdopasqyrë të pozicionit financiar përkthehen me kursin e fundvitit në fund të periudhës përkatëse raportuese;
- (ii) të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin mesatar të këmbimit;
- (iii) komponentët e kapitalit neto janë përkthyer me kursin historik; dhe
- (iv) të gjitha diferencat e kurseve të këmbimit njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Kur humbet kontrolli mbi një filialmenjë monedhë funksionale të ndryshme nga ajo funksionale ose e prezantimit të Grupit, diferencat e kurseve të këmbimit të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen në fitim ose humbje për vitin si pjesë e fitimit ose humbjes nga nxjerrja jashtë përdorimit. Në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të pjesshëm të një filiali pa humbje të kontrollit, pjesa përkatëse e diferencave të akumuluar të konvertimit të monedhave riklasifikohen në interesin jo kontrollues brenda kapitalit.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**Bazat e konsolidimit***i) Kombinimet e biznesit*

Për kombinimet e biznesit llogaritjen bëhen duke përdorur metodën e blerjes kur kontrolli i transferohet Grupit (shih (d) (ii)). Shuma e transferuar në blerje matet përgjithësisht me vlerën e drejtë, siç janë aktivet neto të identifikueshme. Çdo emër i mirë që krijohet testohet çdo vit për zhvlerësim. Çdo fitim nga një blerje njihet në fitim ose humbje të menjëherëshme. Kostot e transaksionit njihen si shpenzime kur ndodhin, përveç nëse lidhen me emetimin e letrave me vlerë të borxhit ose kapitalit. Shuma e transferuar nuk përfshin shumat që lidhen me zgjidhjen e marrëdhënieve para-ekzistuese. Shuma të tilla përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

ii) Filialet

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga Grupi. Grupi kontrollon një njësi ekonomike kur ajo është e ekspozuar ose ka të drejta ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë ekonomike dhe ka aftësinë të ndikojë në këto kthime nëpërmjet fuqisë së saj mbi njësinë ekonomike. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat e konsoliduara nga data kur fillon kontrolli, deri në datën kur ai përfundon.

iii) Interesi jo kontrollues

IJK matet fillimisht me pjesën e tyre proporcionale të aktiveve neto të identifikueshme të blera në datën e blerjes. Ndryshimet në interesin e Grupit në një filial që nuk rezultojnë me humbje të kontrollit kontabilizohen si transaksione të kapitalit neto.

iv) Humbja e kontrollit

Kur Grupi humbet kontrollin mbi një filial, ai çregjistron aktivet dhe detyrimet e filialit, dhe çdo IJK të lidhur dhe përbërës të tjerë të kapitalit neto. Çdo fitim ose humbje që rezultojnë njihet në fitim ose humbje. Çdo interes i mbajtur në ish-filialin matet me vlerën e drejtë kur humbet kontrolli.

v) Transaksionet e eliminuara në konsolidim

Tepricat dhe transaksionet brenda grupit, si dhe çdo e ardhur dhe shpenzim i përealizuar që rrjedh nga transaksionet brenda grupit, eliminohen. Fitimet e përealizuara që rrjedhin nga transaksionet me të investuarit e kontabilizuar në kapital eliminohen kundrejt investimit në masën e interesit të Grupit në të investuarin. Humbjet e përealizuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si fitimet e përealizuara, por deri në masën kur nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

3. Politika domethënëse kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Grupi, përveç rasteve kur deklarohet ndryshe.

(a) Klasifimi i kontratave të sigurimit

Produktet e Grupit klasifikohen në fillim, për qëllime kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi, mbetet si kontratë sigurimi derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet të shuhen ose të skadojnë. Kontratatsipas të cilave Grupi pranon një rrezik të rëndësishëm sigurimi nga një palë tjetër (policëmbajtësi) dukerë në dakord të kompensojë policëmbajtësin ose përfituesin tjetër nëse një ngjarje e caktuar pasigurt e ardhshme (ngjarja e siguruar) ndikon negativisht tek policëmbajtësi ose përfituesit tjetër, klasifikohen si kontrata sigurimi.

Rreziku i sigurimit është një rrezik ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë nga një normë interesi të caktuar, çmimi i instrumentave financiarë, çmimi i mallit, kursi i këmbimit valutor, indeksi i çmimeve ose normat, një vlerësim kredie ose indeksi i kredisë ose ndryshorë të tjerë, të parashikuar në rastin të një ndryshori jo financiar që ai nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë gjithashtu një rrezik financiar.

3. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

(b) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i) Kontratat e sigurimit të përgjithshëm

Detyrimet nga veprimtaria e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e pafituara, rreziku i detyrimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet lidhur me detyrimet e ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e veprimtarisë së sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Grupi nuk i aktualizon detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të posaçme. Filialet e Shoqërisë kanë përdorur kërkesat e rregullatorëve ose strukturave mbikëqyrëse të sigurimit sipas territorit për të përcaktuar detyrimet e veprimtarisë së sigurimit.

ii) Primet nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin e drejtpërdrejtë pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet paraqiten pa përfshirë detyrimet e komisioneve ndaj agentëve/ndërmjetësve dhe përjashtojnë taksën dhe tarifën mbi primet. Primet konsiderohen të fituar që nga data kur i bashkëlidhet rrezikut, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Llogaritë e arkëtueshme nga

sigurimi për të cilat shuma edetyruar vlerësohet të jetë e paarkëtueshme fshihen.

iii) Rezerva e primit të pafituar ("UPR")

Sigurimi i Jo Jetës

Rezervat primit të pafituar në të gjitha linjat e biznesit përfshijn atë pjesë të primeve të shkruara e cila vlerësohet se do të fitohet në vitin pasardhës, duke përdorur metodën proporcionale 1/365, e rregulluar në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Rezerva e primit të pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e shkruara të cilat paraqiten bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj agentëve/ndërmjetësve dhe gjithashtu përjashtojnë taksën dhe tarifën mbi primet. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim shtyhen veçmas si aktiv.

Sigurimi i Jetës

Rezerva për "Jetën e Debitorit" dhe sigurimin e "Jetës së Kombinuar" është përlllogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pa-maturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koeficientin e rrezikut të vdekshmërisë, për rrezikun e humbjes së jetës si dhe ndërkohë UPR-ja për rrezikun e humbjes së jetës nga aksidentet dhe të shëndetit. Grupi ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafituar. Primi i pafituar për sigurimin e mbrojtjes së pagesave ("PPI") është llogaritur bruto para shpenzimeve të marrjes në sigurim. Efekti i kostos së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e kostos së marrjes në sigurim kundrejt primit të shkruar bruto.

iv) Shpenzimet e marrjes në sigurim

Sigurimi i Jo Jetës

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim përfaqësojnë shpenzimet e ndodhura të marrjes në sigurim dhe të ardhurave të marra, të cilat korrespondojnë me rezervën e primit të pafituar. Ato janë përcaktuar si pjesë e shpenzimeve të marrjes në sigurim si përqindje në planin teknik të sigurimeve dhe që lidhen me periudhat ndërmjet fundit të periudhës raportuese dhe datës së përfundimit të afatit të kontratës së sigurimit.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga marrja në sigurim e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot e drejtpërdrejta, siç janë komisionet e marrjes në sigurim.

3. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)***Sigurimi i Jetës***

Shpenzimet eshtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat “Jeta me Afat”, kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogaritet në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primit të pafitur të primeve bruto të shkruara. Rrjedhimisht, kostot e marrjes shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Grupi ka zbatuar qasjen e thjeshtuar të specifikuar në standardet e grupit Uniq. Kështu që për llogaritje është përdorur skedari i thjeshtuar i standardeve i ofruar nga Grupi, së bashku me komisionet, zbritjen, vonesën dhe normat e vdekshmërisë.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përkufizohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit.

iv) Risigurimi

Grupi cedon primet e siguruara dhe rrezikun duke zvogëluar kështu potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linja e biznesit MTPL dhe aksidenteve përfshirë këtu dhe kartonin jeshil, sigurimin e pasurisë, marinës dhe aviacionit, detyrime civile dhe të tjera dhe linja të tjera biznesi.

Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshje të tejkalimit të humbjeve dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe kohës regjistrohen si aktive risigurimi. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur afati i tyre mbaron.

Primet e risiguruara ose primet e ceduara tek risiguresit njihen si shpenzime në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për aktivitetin e përgjithshëm të sigurimit, primet e risigurimit njihen si shpenzime në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguruar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi. Shuma e njohur si aktive të risigurimit matet në mënyrë konsistente me matjet e provizionit të mbajtur për kontratat lidhura të sigurimit. Shumat e njohura si aktive risigurimi maten mbi një bazë që është në përputhje me matjen e provizionit të mbajtur në lidhje me kontratat përkatëse të sigurimit.

Aktivet nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit në lidhje me primet e ceduara tek risiguresit dhe arkëtimet nga shoqëria risigurese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si aktive nga risigurimi dhe paraqiten të veçanta, nëse ka. Aktivet nga risigurimi vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Grupi mund të mos arkëtojë të gjitha shumat dhe ngjarja ka një ndikim të matshëm në shumat që Grupi do të marrë. Grupi nuk ka pasur fitime ose humbje nga aktivet e risigurimit në datën e raportimit.

(d) Instrumentat financiarë

Instrumentet financiare të Grupit maten me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Grupi klasifikon detyrimet financiare jo-derivative në detyrime të tjera financiare

Njohja. Instrumentet financiare të Grupit (aktivet dhe detyrimet) regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, i cili mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të tregut në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

Klasifikimi. Aktivet financiare të Grupit klasifikohen në depozita, llogari të arkëtueshme dhe letra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVPTL). Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit janë aktive të sigurimit. Letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare nuk klasifikohen si të mbajtura deri në maturim pasi nuk ka treg aktiv për këto letra dhe për rrjedhojë ato përmbushin përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshmeve. Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime të tjera financiare (përfshirë detyrimet nga kontratat e sigurimit dhe detyrimet të tjera) dhe llogariten kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme të sigurimit janë aktive financiare jo-derivative të pakuotuar me pagesa fikse ose të përcaktueshme të ndryshme nga ato që Grupi synon të shesë në periudhën e afërt. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme përfshijnë depozitat me afat pranë bankave, llogaritë e tjera të arkëtueshme, bonot dhe obligacionet e thesarit të emetuara nga Qeveria Shqiptare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke i zbritur provizionin për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Çregjistrimi. Grupi çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet janë shlyer ose të drejtat për flukset monetare nga aktivet skadojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për flukset monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje ndërkohë që (i) ose ajo transferon të drejtat për të marrë rrjedhë parash kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar ose (ii) as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për t'ia shitur aktivin në tërësi një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë në shitje. Grupi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

Matja e kostonë së amortizuar. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar njihet në njohjen fillestare minus çdo ripagim të kryeqjësë, plus interesin e përlogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo zhvlerësim për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi. Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose aktualizimi deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat e përlogaritura nga interesi dhe shpenzimet e përlogaritura nga interesi, duke përfshirë kuponin e përlogaritur dhe zbritjen ose primin e amortizuar (përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave të lidhur në pasqyrën e pozicionit financiar

Kompensimi. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen, dhe shumanetoeraportuar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjërisht për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një qëllim që ose të shlyhet në bazën neto, ose të realizohet aktivi dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme, për shembull në aktivitetin tregtar të Grupit.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur ndodhin për shkak të një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarjeve të humbjes") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar dhe që kanë një ndikim në shumën ose kohën e flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të aktivitetit financiar ose grupi i aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Grupi përcakton se nuk ekziston asnjë evidencë objektive që zhvlerësimi ka ndodhur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor dhe i vlerëson ato bashkërisht për zhvlerësim.

Faktorët kryesorë që Grupi merr në konsideratë në përcaktimin nëse një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë statusi i tij i vonuar, detyrimet që mund të kompensohen për të njëjtin klient dhe realizueshmëria e kolateralit të lidhur, nëse ka. Kriteret e tjera kryesore të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi:

- çdo pjesë ose këst është i vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes. pala tjetër përjeton një vështirësi të konsiderueshme financiare
- siç dëshmohet nga informacioni i saj financiar që merr Grupi. palatjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim të aktivitetit.
- ka një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesës së palës tjetër për shkak të ndryshimeve
- në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë në palën tjetër.

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)**Investimet të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes**

Investimet në fondet e investimeve i referohen produkteve në të cilat policëmbajtësi merr përsipër rrezikun e investimit, ku siguruesi nuk ka shumë të garantuar. Siguruesi blen njësi në fondet e investimit me primin e investimit të përcaktuar në propozim dhe sipas polices të lëshuar në bazë të kontratës së sigurimit të jetës. Aktivet financiare në FVTPL fillimisht njihen me vlerën e drejtë në datën e transaksionit, ose kosto, ndërsa kostot e transaksionit njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave. Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet, ose një detyrim të shlyhet, ndërmjet palëve të njohura dhe të gatshme në një transaksion.

Grupi mban aktive financiare, ekspozimi i vlerës së drejtë të të cilave kompenson atë të detyrimeve sipas kontratave të sigurimit që maten duke përdorur teknika që përfshijnë informacionin aktual të tregut. Grupi raporton si detyrimet e sigurimit me vlerën aktuale, ashtu edhe aktivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në mënyrë që të eliminojë mospërputhjen që përndryshe do të rezultonte nga matja e detyrimeve të sigurimit me kosto dhe aktivet financiare si të disponueshme për shitje ose me kosto të amortizuar.

Njësitë në fondet e investimeve të blera në favor të këtyre marrëveshjeve maten në çdo datë raportimi duke përdorur vlerën e aktiveve të fondit në nivel njësie. Vlerësimi i kuotave llogaritet dhe vihet në dispozicion të publikut nga depozitari i fondit të investimeve. Kjo është norma me të cilën një investitor mund të blejë ose shesë një njësi nga emetuesi. Grupi supozon se emetuesi, dmth, fondi i hapur i investimeve, si një njësi ekonomike që i nënshtrohet mbikëqyrjes së veçantë, përdor njësi të certifikuara për të përcaktuar vlerën e drejtë.

(e) Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet origjinal prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Grupi në menaxhimin e angazhimeve të tij afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(f) Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në shumën e kryegjësë së papaguar dhe klasifikohen me maturitet fillestar më shumë se tre muaj. Interesi përlllogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe llogaritet në bazë proporcionale dhe është pjesë e bilancit të depozitave me afat në fund të vitit. Depozitat me afat mbahen me kosto të amortizuar.

(g) Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogaritë e tjera të pagueshmenjihen fillimisht me vlerën e drejtë duke zbritur kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që të cilin i përkasin.

(h) Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme nga siguri dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke zbritur çdo kosto transaksioni që i përkasin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

(f) Aktive afatgjata materiale**(i) Njohja dhe matja**

Aktivetafatgjata materiale maten fillimisht me kosto dhe më pas paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet drejtpërdrejt të atribueshme për blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve, punën direkte (kur është e aplikueshme), si dhe çdo kosto tjetër drejtpërdrejt të atribueshme për ta sjellë aktivin në gjendje pune për përdorimin e synuar, përfshirë kostot e çmontimit dhe largimit të elementeve dhe rikthimit të vendndodhjes ku ato janë të instaluar.

Fitimet dhe humbjet nga çregjistrimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen si diferenca ndërmjet të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivit dhe njihen neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

(ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritët që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Grupin dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të ndërtesës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i përmirësimeve të objekteve me qira realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve, ndërsa vlerësimi i aktiveve të tjera afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e përcaktuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Kategoria	2025	2024
Përmirësimet e ndërtesave	2.50%	2.50%
Mjete motorike	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe pajisje zyre	20%-25%	20%-25%

Vlera e mbetur, nëse, është e rëndësishme rivlerësohet çdo vit. Përmirësimet e qirasë kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës më të vogël të jetës së tyre të dobishme dhe afatit të qirasë.

(g) Aktive me të drejtë përdorimi

Grupi jep me qira zyra të ndryshme. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë. Grupi ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë dhe në vend të kësaj i llogaritet këto si një përbërës të vetëm qiraje. Aktivet me të drejtë të përdorimit maten me koston që përfshin shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë.

Aktivitet me të drejtë të përdorimit maten me koston që përfshin sa më poshtë:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose përpara datës së fillimit minus çdo stimul qiraje të marrë,
- çdo kosto fillestare direkte.

Aktivitet me të drejtë të përdorimit zakonisht amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të jetës së dobishme të aktivitetit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Grupi është në mënyrë të arsyeshme i sigurt se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktiviteti i së drejtës së përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë të përdorimit llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të parashikuar të ndërtesave.

(h) Pasuri e investuar

Prona e investimit është pronë që mbahet nga Grupi për të gjeneruar të ardhura nga qiraja ose për rritje kapitali, ose për të dyja, dhe nuk përdoret nga vetë Grupi. Prona e investimit njihet fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit, dhe më pas matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, kur është e aplikueshme. Amortizimi i ndërtesave llogaritet duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre mbi vlerën e mbetur përgjatë një jete të dobishme të vlerësuar prej 40 vitesh. Toka nuk amortizohet. Nëse ekziston ndonjë tregues që prona e investimit mund të jetë e zhvlerësuar, Grupi vlerëson shumën e rikuperueshme si më e larta ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit (shitjes). Vlera kontabël e pronës së investimit ulet deri në shumën e saj të rikuperueshme përmes një shpenzimi të njohur në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme rikthehet nëse ka pasur një ndryshim të mëvonshëm në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm kur është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin do të rrjedhin te Grupi dhe kur kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes njihen si shpenzim në momentin e ndodhjes. Kur një pronë investimi bëhet e përdorur nga pronari, ajo riklasifikohet në aktive afatgjata materiale.

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

(i) Aktivet jomateriale

Aktivitet jomateriale të Grupit, përveç emrit të mirë, kanë jetë të dobishme të përcaktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe licensa. Licensat e fituara të programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të kostove për blerjen dhe vënien në përdorim të tyre.

Kostot e zhvillimit që lidhen drejtpërdrejt me programet kompjuterike të identifikueshëm dhe unik të kontrolluar nga Grupi regjistrohen si aktive jomateriale nëse është e mundur një hyrje e përfitimeve ekonomike në rritje që tejkalojnë kostot. Kostot e kapitalizuara përfshijnë kostot e stafit të ekipit të zhvillimit të programeve kompjuterike dhe një pjesë të përshtatshme të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programin kompjuterik, përshëmbull, mirëmbajtja e tij, shpenzohen kur ndodhin. Aktivitet jomateriale amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme prej 4 deri në 10 vjet.

Aktivitet jomateriale shpalosen së bashku me aktivet afatgjate materiale në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar dhe shënimet përkatëse të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Në fund të çdo periudhe raportuese, Grupi rishikon vlerat kontabël të aktiveve të tij jomateriale për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, Grupi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot

e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga rënia në vlerë njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga rënia në vlerë e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme anulohet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të aktivit ose vlerën e drejtë minus kostot e shitjes.

(j) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot e lidhura me emetimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si pakësim, neto nga tatimi mbi fitimin. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si prim i aksioneve në kapital.

Dividendët

Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali neto në periudhën në të cilën janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të konsoliduara të autorizohen për emetim janë shpalosur në shënimin e ngjarjeve pas periudhës raportuese.

(k) Rezerva për veprimtarinë e sigurimit

Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në legjislacionin e sigurimeve në vendet ku Grupi operon, dhe ajo përbën një pjesë të caktuar të fitimit të periudhës së mëparshme nëse fitimi nuk përdoret për të mbuluar humbjet e akumuluar të trashëguara nga vitet e mëparshme. Kjo rezervë krijohet për të garantuar fondin e aftësisë paguese dhe të fondit të garancisë.

(l) Njohja e të ardhurave

Politika kontabël lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit është shpalosur në shënimet 4.b.ii. Të ardhurat nga interesi mbi aktivet financiare njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e grupit nga shërbimet përfshijnë kompensimin, të ardhurat nga rimbursimi, shërbimet e agjencisë, të ardhurat nga komisionet. Të ardhurat nga komisioni lidhen me tarifat e menaxhimit të fondeve, të cilat njihen si të ardhura bazuar në një përqindje të caktuar të vlerës së aktiveve neto të fondeve të menaxhuara në çdo datë raportimi në baza vjetore, d.m.th., në periudhën kontabël në të cilën janë kryer shërbimet.

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)**(m) Përfitimet e punonjësve***Sigurimet shoqërore të detyrueshme*

Grupi paguan kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet përkatëse të sigurimeve shoqërore janë përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal të përcaktuar ligjërisht për pensionin sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara. Kontributi i Grupit në planin e përfitimeve të pensioneve ngarkohet në fitim dhe humbje në momentin që ndodh dhe Grupi nuk ka detyrime të mëtejshme.

(p) Detyrimet e qirasë

Detyrimet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht maten mbi bazën e vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave fikse (duke përfshirë pagesat fikse në substancë), minus çdo stimul qiraje të arkëtueshme.

Opsionet e zgjatjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të qirave të pronës. Këto terma përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në drejtim të menaxhimit të aktiveve të përdorura në operacionet e Grupit. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit të mbajtura janë të ushtrueshme si nga Grupi ashtu edhe nga qiradhënësi përkatës. Opsionet e zgjatjes (ose opsionet e periudhës pas përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë). Pagesat e qirasë që do të kryhen sipas disa opsioneve të arsyeshme të zgjatjes përfshihen gjithashtu në matjen e detyrimit. Pagesat e qirasë skontojnë duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira.

Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, gjë që është përgjithësisht rasti për qiratë e Grupit përdoret norma rritëse e huamarrjes, që është norma që Grupi duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivi me të drejtën e përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik me terma, kolateral dhe kushte të ngjashme.

Për të përcaktuar normën në rritje të huamarrjes, Grupi:

- përdor një qasje ngritjeje që fillon me një normë interesi pa rrezik të rregulluar për rrezikun e kredisë, dhe
- bën rregullime specifike të qirasë, p.sh. afati, vendi, monedha dhe kolaterali.

Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike të interesit për tepricën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë. Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtra të pajisjeve, mjeteve motorike dhe të gjitha qiratë e aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak.

(q) Provizionet për detyrimet dhe tarifat*Provizionet për detyrimet*

dhe tarifat janë detyrime jo-financiare në kohë ose vlerë të papërcaktuar. Provizionet përlogariten kur Grupi ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për shkak të ngjarjeve të ndodhura më parë, dhe përfitime ekonomike të kërkohen për të shlyer detyrimin pas një vlerësimi të shumës së detyrimit. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për detyrimin. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të afatit kohor njihet si shpenzim interesi në shpenzimet financiare.

Taksat dhe tarifat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore bazuar në informacionin që lidhet me një periudhë përpara se të lindte detyrimi për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një takse, siç identifikohet nga legjislacioni, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Taksat dhe tarifat, përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një takse, siç identifikohet nga legjislacioni, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si një parapagim. Ndër të tjera, mbi të njëjtën bazë, Grupi krijon provizion për fondin e kompensimit të sigurimit motorik, i cili ndahet nga rregullatorët për të gjitha shoqëritë e sigurimit bazuar nëpeshën e tyre në tregun e sigurimit të mjeteve motorike.

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)**(r) Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë i cili njihet në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur drejtpërdrejt në kapital ose në OCI. Interesi dhe gjokat që lidhen me tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, llogariten sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet Kontingjente.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin e pritshëm të pagueshëm ose tatimin e pritshëm për të ardhurat ose humbjen e tatueshme për vitin dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose merret që pasqyron pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normat tatimore të miratuara ose në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kriteret.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës të mabrtura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Aktivet tatimore të shtyra njihen për kreditë tatimore të papërdorura dhe diferenca të përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundshme që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të planeve të biznesit.

Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor përkatës do të realizohet; këto reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të tatueshme në të ardhmen përmirësohet. Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivekurohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është bërë e mundshme që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferenca të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të pasonin nga mënyra në të cilën Grupi pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të tij. Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kriteret. Grupi nuk ka njohur asnjë aktiv ose detyrim tatimor të shtyrë në këto pasqyra financiare të konsoliduara duke qenë se drejtimi e konsideron ndikimin e tij të mos jetë material.

4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme në zbatimin e politikave kontabël

Grupi bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe në vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Drejtimi gjithashtu bën disa gjykime, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Pretendimet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që lind nga pretendimet e bëra sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më kritik i Grupit. Vendimet e Grupit për humbjet e raportuara dhe të pararaportuara dhe vendosja e provizioneve rezultuese dhe risigurimeve të rikuperueshme rishikohen dhe përditësohen çdo vit, dhe rregullimet që rezultojnë nga ky rishikim pasqyrohen në fitim ose humbje.

Procesi bazohet në supozimin se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve aktuale dhe tendencave të mundshme, është një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit është diskutuar në detaje në Shënimin 8, ndërsa dispozitat e kontratave të sigurimit janë analizuar në Shënimin 19.

4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme në zbatimin e politikave kontabël***Dëmet që lidhen me veprimtarinë e përgjithshme të sigurimit***

Dëmet e ndodhura përfshijnë kostot e shlyerjes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarjet që kanë ndodhur gjatë vitit financiar së bashku me rregullimet në provizionet e dëmeve të vitit të kaluar.

Sigurimi i jo jetës

Kërkesat e papaguara vlerësohen duke shqyrtuar pretendimet individuale dhe duke bërë kompensim për dëmet e shkaktuara por të paraportuara, efektin e ngjarjeve të parashikueshme të brendshme dhe të jashtme, të tilla si ndryshimet në procedurat e trajtimit të dëmeve, inflacioni, tendencat gjyqësore, ndryshimet legjislative dhe përvoja dhe tendencat e kaluara. Provizionet për dëmet e papaguara nuk zbriten. Rregullimet për provizionet e pretendimeve të krijuara në vitet e mëparshme pasqyrohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën janë bërë rregullimet dhe shpalosen veçmas nëse janë të rëndësishme. Provizioni për dëmet e shkaktuara por të paraportuara është vlerësuar në bazë të metodës së trekëndësheve të paguar për produktin e Detyrimeve ndaj Palëve të Treta ("MTPL") ndërsa për linjat e tjera të biznesit përdoret një metodologji e thjeshtuar e bazuar në raportin e primit të fituar.

Sigurimi i jetës

Provizionipërfaqëson koston përfundimtare të vlerësuar të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot e shlyerjes direkte dhe indirekte, që lindin nga ngjarjet që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, duke përfshirë një vlerësim për koston e dëmeve të shkaktuara por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Provizioni për dëmet e papaguara krijohet rast pas rasti me shumën e pagesës së pritshme. Provizioni për dëmet e shkaktuara por të pa raportuara krijohet duke përdorur metodën e shkallëve zinxhir. Pretendimet e biznesit të sigurimit të jetës pasqyrojnë koston e të gjitha dëmeve që lindin gjatë vitit, duke përfshirë bonuset e policave të alokuara në pritje të një deklarate bonusi.

i) Rezerva të tjera matematikore të sigurimit të jetës

Provizioni i sigurimit të jetës llogaritet mbi bazën e policës duke përdorur metodën e perspektivës neto. Supozimet mbi vdekshmërinë dhe normën e interesit të përdorura në rezervim janë në përputhje me supozimet e çmimit ku një interval prej 80 deri në 85% e kthimit shtesë kthehet pasi kalon afati i policës.

ii) Kostot e trajtimit të dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve përbëhen nga shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzimet e brendshme të trajtimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë jo të rëndësishme në krahasim me kostot e jashtme. Grupi krijon një provizion për kostot e trajtimit të dëmeve brenda provizioneve përkatëse të trajtimit të dëmeve, përveç rezervave për dëmet e papaguara.

iii) Detyrimet për dëmet në proces gjyqësor

Njëpjesë e konsiderueshme dëmeve janë në proces gjyqësor. Ndërsa drejtimi konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe dëmet e paguara nga risiguruesit, duke përfshirë rezervat dhe kushtëzimet për dëmet sipas një procesi ligjor, janë deklaruar në mënyrë të drejtë, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme të shumave.

Rregullimet në shumat e detyrimeve të sigurimit pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën janë bërë rregullimet.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve***Sigurimi i jo-jetës***

Nëçdo datë raportimi Grupi kryen teste për të siguruar përshtatshmërinë e rezervave të dëmeve. Testet primare të kryera janë analiza "Raporti i dëmeve" dhe analiza "Run-off" e rezervave të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht në linjat kryesore të biznesit. Llogaritja kryhet për dëmet veçmas, si dhe për dëmet që përfshijnë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe çdo shpenzim tjetër të trajtimit të dëmeve. Në kryerjen e kësaj analize, Grupi merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse monetare. Grupi nuk i aktualizon këto flukse monetare të vlerësuara sepse shumica e dëmeve priten dhe kërkohen të shlyhen brenda një viti.

4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Për më tepër, Grupi kryen çdo vit një analizë “Run-off” të rezervave të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e tij të rezervimit. Analiza “Run-off” kryhet në bazë të RBNS dhe IBNR veçmas si dhe në bazë të kombinuar. Në rast se analiza tregon mospërputhje të mëdha, rregullimet e duhura bëhen në metodologjinë e rezervimit. Nëse identifikohet një mangësi, ajo do të ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një rezervë për rrezikun e paskaduar nga humbjet që rrjedhin nga Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve.

Sigurimi i jetës

Nëçdo datë raportimi, Grupi kryen teste për të siguruar mjaftueshmërinë e detyrimeve të kontratës së sigurimit të jetës. Testet primare të kryera janë analiza e raportit të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit në linjat kryesore të biznesit të jetës individualisht (jeta në kredi dhe jeta e kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm për dëmet, si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjes dhe çdo kosto tjetër të trajtimit të dëmit. Në kryerjen e kësaj analize, Grupi merr parasysh vlerësimet aktuale të daljeve të parasë. Grupi nuk i skonton këto flukse monetare dalëse të vlerësuar sepse shumica e dëmeve pritet të shlyhen brenda një viti. Për më tepër, Grupi kryen çdo vit një analizë të rrjedhës së detyrimeve të kontratave të sigurimit për të vlerësuar metodologjinë e rezervimit të tij. Nëse identifikohet një mangësi, ajo do të ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provizion rreziku të paskaduar nga humbjet që rrjedhin nga Testi i Mjaftueshmërisë së Përgjegjësisë. Grupi ka llogaritur LAT-në për sigurimin afatgjatë të jetës përmes metodave të jo-jetës dhe për jeta në kursim përmes metodave të jetës bazuar në vlerësimet aktuale të flukseve të ardhshme të parasë në mënyrë që të vlerësojë përshtatshmërinë e rezervës për jetë në kursim.

Supozimet dhe ndjeshmëritë janë të shpalosura në Shënimin 6 të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

5. Shpallje të reja të kontabilitetit

Grupi pritet të adaptojë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNRF), nga 1 janari 2028. SNRF 1 do të zbatohet duke u aplikuar në mënyrë të përshtatshme me rrethanat.

6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit

Grupi pranon rrezikun e sigurimit nëpërmjet kontratave të sigurimit ku merr përsipër rrezikun e humbjes nga personat ose shoqëritë. Grupi është i ekspozuar ndaj pasigurive lidhur me kohën, shpeshtësinë dhe madhësinë e dëmeve sipas këtyre kontratave.

Rreziku i sigurimit lidhet me pasigurinë e biznesit të sigurimeve. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e provizioneve në lidhje me detyrimet e sigurimit dhe bazën e kapitalit. Rreziku i primit është i pranishëm kur polica lëshohet përpara se të ketë ndodhur ndonjë ngjarje e siguruar.

Rreziku është që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara do të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku i rezervës përfaqëson rrezikun që niveli absolut i provigjoneve teknike është vlerësuar gabimisht ose që pretendimet aktuale do të luhaten rreth vlerës së mesatares statistikore.

Administrimi i rreziqeve

Grupi administron rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së saj të planit të risigurimit brenda një kuadri të përgjithshëm të administrimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozime që kanë të bëjnë me ecurinë dhe përvojën mëparshme. Ekspozimet ndaj rreziqeve administrohen përmes kufizimeve dhe kriterëve të vendosura në kontratat e nënshkruara. Risigurimi minimizon efektin e humbjes potenciale të Grupit nga ngjarje të mëdha ose katastrofike dhe gjithashtu ndikon në aksesin e specialistëve ndaj rreziqeve dhe lehtëson administrimin e kapitalit. Politikat e risigurimit janë të dakordësuara me risiguresit e aprovuar, të kuotuar ose bazohen në terma të limiteve të marrëveshjes për kufjtë e humbjeve. Kapitali rregullator administrohet duke iu referuar rrezikut të sigurimit në të cilin është ekspozuar Grupi.

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.**Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2025***(Të gjitha shumat janë në mijëlekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)**

Më poshtë paraqitet përmbledhja e detyrimeve për humbje dhe shpenzime të rregullimit të humbjeve për Grupin për vitet 2025 dhe 2024:

2025								
	Bruto (A)	Risigurimi (B)	Neto	UPR (C)	Risigurimi (D)	Neto	Totali rezerves (A+C)	Totali Risigurimi rezerves (B+D)
Biznesi jo-jetë*	6,268,881	(1,183,837)	5,085,044	5,632,579	(367,481)	5,265,098	11,901,460	(1,551,318)
Biznesi jetë**	2,430,352	(31,133)	2,399,219	1,160,243	(12,344)	1,147,899	3,590,595	(43,477)
Total	8,699,233	(1,214,970)	7,484,263	6,792,822	(379,825)	6,412,997	15,492,055	(1,594,795)

*Të dhënat sipas linjave të biznesit dhe territorit të operimit për aktivitetin jo-jetë paraqiten në tabelat e shpalosura në faqen 18.

**Të dhënat sipas linjave të biznesit dhe territorit të operimit për aktivitetin e jetës paraqiten në tabelat e shpalosura në faqen 20.

2024								
	Bruto (A)	Risigurimi (B)	Neto	UPR (C)	Risigurimi (D)	Neto	Totali rezerves (A+C)	Totali Risigurimi rezerves (B+D)
Biznesi jo-jetë*	6,906,149	(1,721,669)	5,184,480	4,883,381	(399,122)	4,484,259	11,789,530	(2,120,791)
Biznesi jetë**	2,292,240	(18,144)	2,274,096	1,100,884	(1,034)	1,099,850	3,393,124	(19,178)
Total	9,198,389	(1,739,813)	7,458,576	5,984,265	(400,156)	5,584,109	15,182,654	(2,139,969)

*Të dhënat sipas linjave të biznesit dhe territorit të operimit për aktivitetin jo-jetë paraqiten në tabelat e shpalosura në faqen 18.

**Të dhënat sipas linjave të biznesit dhe territorit të operimit për aktivitetin e jetës paraqiten në tabelat e shpalosura në faqen 20.

Sigurimi i jo-jetës

Grupi nënshkruan rreziqe të sigurimit të pronës, përgjegjësisë, shëndetit dhe automjeteve motorike, kryesisht me një periudhë mbulimi prej dymbëdhjetë muajsh. Rreziqet më të rëndësishme burojnë nga fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe katastrofa të tjera, të cilat karakterizohen nga frekuencë e ulët, por me ndikim të lartë.

Një përqendrim i rrezikut mund të lindë gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar për lloje të caktuara biznesesh komerciale që janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndodhjes së një ngjarjeje të përbashkët të siguruar.

Shpërndarja e dëmeve të paguara është përmbledhur si më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

	2025			2024		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit të jo-jetës						
Mjete motorike	4,623,737	(263,565)	4,360,172	4,440,793	(225,007)	4,215,786
Prona	1,531,490	(920,272)	611,218	2,335,769	(1,496,661)	839,108
Shëndeti dhe aksidentet	113,654	-	113,654	129,587	-	129,587
Totali	6,268,881	(1,183,837)	5,085,044	6,906,149	(1,721,668)	5,184,481

Shpërndarja e dëmeve të paguara sipas vendndodhjes është përmbledhur më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

	2025			2024		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Vendndodhja						
Shqipëria	3,386,846	(723,194)	2,663,652	3,631,909	(734,376)	2,897,533
Kosova	1,988,005	(390,258)	1,597,747	2,527,383	(936,029)	1,591,354
Republika e Maqedonisë së Veriut	894,030	(70,385)	823,645	746,857	(51,263)	695,594
Totali	6,268,881	(1,183,837)	5,085,044	6,906,149	(1,721,668)	5,184,481

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.**Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2025***(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)**

Shpërndarja e rezervave për primin e pafitur (UPR) sipas llojit të kontratës është përmbledhur më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

	Bruto	2025 Risigurimi	Neto	Bruto	2024 Risigurimi	Neto
Linja e biznesit të jo jetës						
Mjete motorike	3,622,509	(2,233)	3,620,276	3,097,513	(1,053)	3,096,460
Prona	1,438,385	(359,039)	1,079,346	1,375,478	(387,041)	988,437
Shëndeti dhe aksidentet	571,685	(6,209)	565,476	410,390	(11,028)	399,362
Totali	5,632,579	(367,481)	5,265,098	4,883,381	(399,122)	4,484,259

Përqendrimi i provizioneve të primit (UPR) sipas vendndodhjes është përmbledhur më poshtë duke iu referuar vendndodhjeve:

	Bruto	2025 Risigurimi	Neto	Bruto	2024 Risigurimi	Neto
Vendndodhja						
Shqipëria	3,407,476	(269,693)	3,137,783	2,945,359	(294,025)	2,651,334
Kosova	875,693	(39,731)	835,962	804,729	(24,080)	780,649
Republika e Maqedonisë së Veriut	1,349,410	(58,057)	1,291,353	1,133,293	(81,017)	1,052,276
Totali	5,632,579	(367,481)	5,265,098	4,883,381	(399,122)	4,484,259

Sigurimi i jetës

Në parim, të gjitha produktet e jetës të marra në sigurim nga Grupi mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, në disa raste mbulimi është i kufizuar në mbulim të pjesshëm, humbje për shkak të aksidenteve. Produktet e tjera përveç fondit të kompensimit kanë karakteristika të ngjashme të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me një opsion për të ndryshuar primin nga Grupi. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit që kanë një efekt material në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të ardhshme që rrjedhin nga kontrata e sigurimit janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i jetës për hua

Kontratat e klasifikuara si “Sigurim i Jetës për hua” janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe ofrohen për bankat sëbashku me kredinë. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

Sigurimi i kombinuar

Sigurimi i kombinuar përbëhet nga polica përmes të cilave Grupi nënshkruan mbulimet në grup. Kontratat e jetës me afat shlyejnë përfitimet e garantuara në rast vdekjeje të cilat janë të përcaktuara në shumën e sigurimit fikse që nuk varen nga Grupi. Kontratat lëshohen për individë dhe grupe individësh.

Jeta me kursim

Përfshin sigurimin e jetës dhe një komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 5 në 30 vjet. Në rast të daljes nga sigurimi gjatë tre viteve të parë të policës, Grupi nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit ardhmen. Pas përfundimit të kësaj periudhe, Grupi paguan vlerën e dorëzimit të përcaktuar sipas kushteve të policës. Produkti është afatgjatë dhe përfshin përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të ardhmen. Përfitimi në rast vdekjeje është i barabartë me shumën e komponentit të kursimit të rezervës dhe shumën e siguruar, e cila varion në intervalin ALL 305,019 deri në ALL 10,642,958.

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.**Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2025***(Të gjitha shumat janë në mijëlekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)**

Përqendrimi i jetës për rezervën teknike dhe matematikore, rezervën e primit të pafituar, aktivet e risigurimit është përmbledhur më poshtë:

31 dhjetor 2025	RBNS dhe IBNR	Rezerva matematikore	UPR	Totali	Risigurimi	Neto
Lloji i produktit						
Sigurim Jeta për hua	1,047,736	-	1,070,304	2,118,040	(32,277)	2,085,763
Sigurim Jeta e kombinuar	15,856	-	25,156	41,012	(11,130)	29,882
Sigurim Jetë me kursim	-	1,366,760	64,783	1,431,543	(70)	1,431,473
Totali	1,063,592	1,366,760	1,160,243	3,590,595	(43,477)	3,547,118

31 dhjetor 2024	RBNS dhe IBNR	Rezerva matematikore	UPR	Totali	Risigurimi	Neto
Lloji i produktit						
Sigurim Jeta për hua	1,071,471	-	866,803	1,938,274	(10,373)	1,927,901
Sigurim Jeta e kombinuar	-	-	161,472	161,472	(8,673)	152,799
Sigurim Jetë me kursim	-	1,220,769	72,609	1,293,378	(132)	1,293,246
Totali	1,071,471	1,220,769	1,100,884	3,393,124	(19,178)	3,373,946

Dëmet aktuale të sigurimit të jo-jetës krahasuar me vlerësimet

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të shkaktuara krahasuar me vlerësimet e mëparshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 dhe 2024:

	2025	2024
RBNS		
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit(A)	4,263,955	3,434,109
Dëmet e periudhave të mëparshme të paguara gjatë vitit	(1,441,206)	(1,120,252)
Vlerësimet në fund të vitit për dëmet të periudhave të mëparshme	(2,508,308)	(2,819,834)
Shmangia në Lekë '000(B)	314,441	(505,977)
Shmangia në Lekë % (B/A)	7.4%	(14.7%)
IBNR		
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit (A)	2,260,992	2,187,999
Dëmet e periudhave të mëparshme të raportuara gjatë vitit	(456,494)	(438,426)
	(1,498,804)	(1,687,377)
Shmangia në Lekë '000(B)	305,694	62,196
Shmangia në Lekë % (B/A)	13.5%	2.8%
Rezervat teknike për dëmet		
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit	6,524,946	5,622,109
Dëmet të paguara dhe të raportuara gjatë periudhës	(1,897,698)	(1,558,677)
Vlerësimet në fund të vitit për dëmet	(4,007,112)	(4,507,211)
Shmangia në Lekë '000	620,136	(443,779)
Shmangia në Lekë %	9.50%	(7.89%)

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.**Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2025***(Të gjitha shumat janë në mijëlekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)**

Drejtimi rishikon vlerësimet dhe supozimet për dëmet bazuar në zhvillimin aktual të dëmeve, përfshirë përdorimin e trekëndëshave të dëmeve. Tabela e mëposhtme paraqet zhvillimin e kostos së vlerësuar përfundimtare të dëmeve të ndodhjes për biznesin jo-jetë. Vlerësimet rishikohen në vijimësi për të reflektuar ndryshimet në lundrimin si rezultat i informacionit shtesë të disponueshëm. Krahasimi ndërmjet përfundimit të njohura tregon se niveli i provizioneve për dëme është i mjaftueshëm, duke përfshirë edhe provizionet për dëme të ndodhura por të pa-

Periudha e kontabilizimit	2018 dhe mëherët	2019	2020
Vlerësimi i shpenzimeve përfundimtare për dëmet		3,959,459	2,173,873
Në fund të periudhës raportuese	127,786,759	4,089,249	2,134,012
Një vit më vonë	22,397,327	4,190,799	2,084,368
Dy vite më vonë	22,397,048	3,973,119	2,146,182
Tre vite më vonë	22,683,991	3,995,933	2,075,286
Katër vite më vonë	22,711,144	4,032,127	2,012,523
Pesë vite më vonë	22,728,058	4,065,417	-
Gjashtë vite më vonë	22,990,880	-	-
Shtatë vite më vonë	22,720,146		
Vlerësimi aktual i shpenzimeve kumulative të dëmeve	22,720,146	4,065,417	2,012,523
Pagesat kumulative për dëme	21,918,021	3,837,930	1,819,170
Detyrimet e njohura	802,125	227,488	193,353
Kosto të trajtimit të dëmeve			
Totali*			

* Shihni përmbledhjen e detyrimeve për dëmet dhe shpenzimet e rregullimit të dëmeve (shënimi 6, faqja 18).

